



Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut

ISH-REPUBLIKA JUGOSLLAVE E MAQEDONISË

REFERENDUMI
30 shtator 2018

Misioni i ODIHR-it për Vëzhgimin e Referendumit
Raporti përfundimtar



21 janar 2019
Varshavë

PËRMBAJTJA

I.	PËRMBLEDHJE	1
II.	HYRJE DHE MIRËNJOHJE	3
III.	KONTEKSTI POLITIK	4
IV.	KORNIZA LIGJORE	5
V.	ADMINISTRIMI I REFERENDUMIT	7
VI.	REGJISTRIMI I VOTUESVE	10
VII.	FUSHATA E REFERENDUMIT	11
VIII.	FINANCIMI I FUSHATËS	13
IX.	MEDIAT	15
	A. AMBIENTI MEDIATIK	15
	B. KORNIZA LIGJORE.....	15
	C. MONITORIMI I MEDIAVE NGA MVR-JA	16
	D. MBIKËQYRJA E MEDIAVE.....	17
X.	VËZHGESIT QYTETARË DHE NDËRKOMBËTARË	18
XI.	KUNDËRSHTIMET DHE ANKESAT	19
XII.	DITA E REFERENDUMIT	21
	A. VOTIMI, NUMËRIMI DHE NXJERRJA E REZULTATEVE.....	21
	B. SHPALLJA E REZULTATEVE DHE ZHVILLIMET PAS REFERENDUMIT	22
XIII.	REKOMANDIMET	23
	A. REKOMANDIMET PRIORITARE.....	23
	B. REKOMANDIME TË TJERA	24
	ANEKSI I: REZULTATET PËRFUNDIMTARE	26
	ANEKSI II: LISTA E VËZHGESVE NË MISIONIN NDËRKOMBËTAR PËR VËZHGIMIN E REFERENDUMIT	27
	PËR OSBE/ODIHR-IN	32

ISH-REPUBLIKA JUGOSLLAVE E MAQEDONISË REFERENDUMI

30 shtator 2018

Raporti përfundimtar i Misionit të ODIHR-it për Vëzhgimin e Referendumit¹

I. PËRMBLEDHJE

Në përgjigje të ftesës nga autoritetet e vendit, Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) krijoi Misionin për Vëzhgimin e Referendumit (MVR) për referendumin e 30 shtatorit të vitit 2018. Për ditën e referendumit, MVR-ja e ODIHR-it i bashkoi përpjekjet me një delegacion të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës për ta formuar Misionin Ndërkombëtar për Vëzhgimin e Referendumit (MNVR). MVR-ja e ODIHR-it vlerësoi nëse referendumi u zhvillua në përputhje me angazhimet e OSBE-së, detyrimet dhe standardet e tjera ndërkombëtare, si dhe me legjislacionin e vendit.

Në Deklaratën e Gjetjeve dhe Përfundimeve Paraprake të lëshuar nga MNVR-ja më 1 tetor thuhet se: "Edhe pse korniza ligjore nuk i mbuloi mjaftueshëm të gjitha aspektet, referendumi i 30 shtatorit u administrua në mënyrë të paanshme dhe liritë themelore u respektuan gjatë gjithë fushatës. Administrata zgjedhore ishte kolegjinale dhe iu përmbajt afateve kohore, por nuk ishte gjithmonë plotësisht transparente në punën e saj. Mungesa e fushatës së organizuar 'Kundër' ose për bojkotim, bëri që mediat ta kishin të vështirë të ofronin mbulim të balancuar, megjithatë ato u përcollën votuesve informata të bollshme dhe pikëpamje të ndryshme. Dita e referendumit në përgjithësi ishte e qetë dhe e organizuar mirë, dhe procedurat u administruan në mënyrë profesionale dhe transparente".

Më 30 korrik, Kuvendi shpalli referendum konsultues për miratimin e Marrëveshjes bilaterale me Greqinë, e cila parashihte ndryshime kushtetuese të cilat do të përfshinin ndryshimin e emrit kushtetues të vendit. Në referendum, nga votuesit u kërkua të vendosin se "A jeni për anëtarësim në BE dhe NATO duke e pranuar Marrëveshjen ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Greqisë?". Për të hyrë në fuqi marrëveshja bilaterale, për çdo ndryshim kushtetues do të nevojiten një sërë miratimesh parlamentare, duke përfshirë edhe një shumicë përfundimtare votash prej dy të tretave, e më pas edhe miratimi i marrëveshjes nga parlamenti i Greqisë.

Korniza ligjore për referendumin nuk është as gjithëpërfshirëse dhe as e harmonizuar. Ligji për Referendumin i përcakton rregullat themelore për procesin e referendumit, por ka mungesë të detajeve për çështje të rëndësishme siç është zhvillimi i fushatës dhe financimi i fushatës, dhe është në kundërshtim me disa dispozita të Kodit Zgjedhor, si për shembull përbërja e Këshillave Zgjedhore, procedurat për zgjidhjen e kontesteve dhe prania e vëzhguesve partiakë në vendvotime. Përpjekjet e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve (KSHZ) për t'i plotësuar këto zbrazëtira dhe për t'i qartësuar çështjet tjera nëpërmjet rregulloreve shpeshherë kishin mungesë të bazës ligjore dhe ngritën pyetje në lidhje me diapazonin e kompetencës rregullatore të KSHZ-së.

Ligji kërkon që në referendum të dalin shumica e votuesve të regjistruar që ai të konsiderohet i miratuar, mirëpo nuk thekson në mënyrë eksplicite se a vlen kjo edhe për referendumin konsultativ. Megjithëse qeveria njoftoi synimin e saj për të vazhduar me ndryshimet kushtetuese pa marrë parasysh pjesëmarrjen e votuesve në referendum, fushata për bojkotim në mënyrë implicite e lidhi kufirin e pjesëmarrjes me suksesin e referendumit. Kur pjesëmarrja e votuesve në referendum nuk e arriti kufirin e pjesëmarrjes,

¹ Versioni në gjuhën angleze i këtij raporti është dokumenti i vetëm zyrtar. Janë siguruar edhe përkthime jozyrtare në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën shqipe.

KSHZ-ja konkludoi se "vendimi nuk është miratuar", ndërsa qeveria deklaroi se rezultatet e konfirmuan mbështetjen e votuesve për integrimin në BE dhe NATO. Interpretimet e ndryshme të kufirit të pjesëmarrjes krijuan paqartësi në lidhje me pasojat procedurale të votimit.

KSHZ-ja e administroi referendumin në mënyrë të paanshme dhe në përgjithësi iu përmbajt afateve ligjore. Mbledhjet publike u zhvilluan në mënyrë efikase dhe kolegiale, por nuk ishin të hapura për mediat dhe kishin mungesë të debatit përmbajtësor. Komisionet e nivelit më të ulët në përgjithësi punuan në mënyrë profesionale dhe e gëzuan besimin e palëve të interesuara vendore. Tre nga shtatë anëtarë të KSHZ-së ishin gra, dhe në dy të tretat e këshillave të vëzhguara zgjedhore kryetaret ishin gra.

Në përputhje me një rekomandim të mëparshëm të ODIHR-it, KSHZ-ja zhvilloi fushatë për informimin e zgjedhësve, duke përfshirë përmbajtje televizive dhe onlajn, e cila u fokusua në procedurat e ditës së referendumit. Ndonëse autoritetet bënë disa përpjekje për të ofruar informata neutrale për çështjen për të cilën do të vendoset, thelbi i marrëveshjes dhe pasojat procedurale të referendumit nuk u shpjeguan sa duhet. Mediat transmetuese kryesisht ofruan disa programe informative për marrëveshjen dhe referendumin, që e përmirësoi aftësinë e votuesve për të marrë vendim në bazë të informatave.

Qytetarët që kanë mbushur 18 vjet kanë të drejtë vote, përveç atyre që u është hequr kjo e drejtë ligjore me vendim gjyqësor, gjë që është në kundërshtim me standardet ndërkombëtare. Pozitivisht, autoritetet bënë disa përpjekje për ta lehtësuar rinovimin e dokumenteve të identifikimit për zgjedhësit me të drejtë vote që vuanin dënime me burg. Megjithatë saktësia e listës së votuesve nuk u përmend si shqetësim kryesor nga bashkëbiseduesit e MVR-së së ODIHR-it, çështjet e hershme të pazgjidhura që kanë të bëjnë me përpunimin dhe saktësinë e të dhënave për regjistrimin e zgjedhësve mbeten për t'u trajtuar.

Fushata ishte në përgjithësi aktive dhe paqësore anembanë vendit, dhe të drejtat për tubim, bashkim dhe shprehje u respektuan. Kuvendi si propozues i autorizuar i referendumit e udhëhoqi fushatën 'Për', kryesisht nëpërmjet partive në pushtet, LSDM-së dhe BDI-së. Fushata 'Për' kishte një shkallë të lartë të përfshirjes ndërkombëtare, dhe mori mbështetje të qartë nga përfaqësuesit e nivelit të lartë të BE-së dhe NATO-s. Shumica e partive etnike shqiptare, turke dhe rome u angazhuan për votën 'Për', por zhvilluan fushata të ndara me mesazhe që u dedikoheshin bashkësive të tyre. Në mungesë të fushatës së organizuar 'Kundër', koalicioni për 'Bojkotim' e kundërshtoi referendumin në një fushatë të gjerë në mediat sociale, e cila shpeshherë kishte përmbajtje nxitëse.

Korniza ligjore për financimin e fushatës së referendumit nuk përmban kufizime për shpenzim dhe ka mungesë të kërkesave të qarta për bërjen publike të shpenzimeve, procedurave për revizion dhe sanksioneve. Qeveria i ndau Kuvendit rreth 1.3 milionë euro për t'i harxhuar për reklama në media, të cilat partitë opozitare i refuzuan, prandaj u shpenzua vetëm pjesa e fushatës 'Për' e mjeteve publike. Vetëm nga Kuvendi, si propozues i autorizuar, u kërkua të raportojë për shpenzimin e mjeteve publike, edhe atë vetëm pas ditës së votimit, gjë që e zvogëloi transparencën.

Mediat u ofruan qytetarëve informata të bollshme në lidhje me referendumin. Reklamata në lidhje me fushatën u emetuan rregullisht në mediat private. Mediat publike nuk ishin të obliguara të ofrojnë hapësirë për transmetim falas. Duke pasur parasysh mungesën e fushatës aktive 'Kundër', në kombinim me fushatën për 'Bojkot' që u zhvillua kryesisht në mediat sociale, pikëpamjet e shprehura nga fushata 'Për' qartazi dominuan në mesin e të gjithë transmetuesve. Shumica e kanalave të monitoruara televizive organizuan programe speciale ku u ofruan informata të ndryshme për kontekstin më të gjerë të referendumit.

Kodi Zgjedhor dhe rregullat e KSHZ-së parashohin vëzhgim të referendumit nga vëzhguesit ndërkombëtarë dhe ata qytetarë. “Propozuesi” i referendumit, në këtë rast Kuvendi, kishte të drejtë të emërojë përfaqësues për të vëzhguar në vendvotime, por vendosi të mos e bëjë këtë. Partive politike nuk iu lejua ta vëzhgojnë administrimin e referendumit dhe procedurat e ditës së votimit, gjë që e zvogëloi transparencën e procesit dhe i sfidon angazhimet e OSBE-së.

Votuesit kishin të drejtë të parashtrajnë kundërshtime në KSHZ në lidhje me parregullsitë në procesin e tyre të votimit. Para ditës së referendumit, KSHZ-ja i shqyrtoi kundërshtimet në seanca të mbyllura dhe nuk i publikoi vendimet, në kundërshtim me kërkesat ligjore për transparencë. Gjykata Kushtetuese pranoi tre iniciativa që e kontestuan vendimin e Kuvendit për ta mbajtur referendumin, duke përfshirë formulimin e pyetjes dhe natyrën konsultative të referendumit. Këto iniciativa u refuzuan.

Procesi i ditës së referendumit ishte i organizuar mirë dhe u administrua në mënyrë profesionale, pa parregullsi të mëdha. Procedurat e votimit, numërimit dhe nxjerrjes së rezultateve në përgjithësi u respektuan dhe u siguroa transparenca e procesit. Edhe pse KSHZ-ja lëshoi udhëzim duke kërkuar që të gjitha vendvotimet të vendosen në katin përdhes të ndërtesave komunale, në më shumë se gjysmën e vendvotimeve të vëzhguara personat me aftësi të kufizuara fizike nuk mund të hynin në mënyrë të pavarur. Në shumë raste, vëzhguesit e akredituar qytetarë me sa duket kishin lidhje me partitë politike.

Ky raport ofron një numër rekomandimesh për t’i mbështetur përpjekjet për t’i afruar proceset e referendumit dhe të zgjedhjeve në përputhje me angazhimet e OSBE-së dhe detyrimet dhe standardet e tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike. Rekomandimet prioritare kanë të bëjnë me përmirësimin dhe harmonizimin e rregulloreve që janë specifike për referendumin, përmirësimin e mirëmbajtjes së listës së votuesve, shfuqizimin e kufizimeve të paarsyeshme mbi të drejtat e zgjedhësve dhe transparencën e zgjidhjes së kontesteve. ODIHR-i është i gatshëm për t’u ndihmuar autoriteteve që ta përmirësojnë procesin zgjedhor dhe t’i trajtojnë rekomandimet që gjenden në këtë raport dhe në raportet e mëparshme.

II. HYRJE DHE MIRËNJOHJE

Në përgjigje të ftesës nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe në bazë të rekomandimeve të Misionit për Vlerësimin e Nevojave të realizuar prej 6 deri më 19 gusht, Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) më 27 gusht e krijoi Misionin për Vëzhgimin e Referendumit (MVR) për ta vëzhguar referendumin e 30 shtatorit. MVR-ja e udhëhequr nga ambasadori Jan Petersen, përbëhej nga 17 anëtarë të ekipit kryesor në Shkup dhe 20 vëzhgues afatgjatë të cilët më 5 shtator u shpërndanë në mbarë vendin. MVR-ja mbeti në vend deri më 13 tetor për t’i ndjekur zhvillimet pas referendumit.

Për ditën e referendumit, MVR-së së ODIHR-it iu bashkua një delegacion i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës (APKE) për ta formuar Misionin Ndërkombëtar për Vëzhgimin e Referendumit (MNVR). Z. Stefan Schennach e udhëhoqi delegacionin e APKE-së. Të dyja institucionet e përfshira në këtë MNVR e kanë miratuar Deklaratën e Parimeve për Vëzhgimin Ndërkombëtar të Zgjedhjeve të vitit 2005. Gjithsej u shpërndanë 206 vëzhgues nga 35 vende, duke përfshirë 198 vëzhgues afatgjatë dhe afatshkurtër të shpërndarë nga ODIHR-i, si dhe një delegacion 8-anëtarësh nga APKE-ja. Procedurat e hapjes u vëzhguan në 77 nga 3,480 vendvotime, votimi u vëzhgua në 896 vendvotime, numërimi në 81 vendvotime, ndërsa nxjerrja e rezultateve në 73 nga 81 Komisione Zgjedhore Komunale (KZK).

Misioni vlerësoi se a u zhvillua procesi i referendumit në përputhje me angazhimet e OSBE-së, detyrimet dhe standardet e tjera ndërkombëtare, si dhe me legjislacionin e vendit. Ky raport përfundimtar vjen pas Deklaratës për Gjetjet dhe Përfundimet Paraprake, që u publikua në konferencën për shtyp në Shkup më 1 tetor.²

MNVR-ja dëshiron ta falënderojë Ministrinë e Punëve të Jashtme për ftesën për vëzhgimin e referendumit dhe Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve (KSHZ) për ndihmën e tij. MNVR-ja po ashtu u shpreh falënderim edhe institucioneve të tjera, partive politike, mediave dhe organizatave të shoqërisë civile për këmbimin e pikëpamjeve të tyre, si dhe përfaqësuesve rezident të bashkësisë ndërkombëtare dhe Misionit të OSBE-së në Shkup për bashkëpunimin e tyre.

III. KONTEKSTI POLITIK

Zgjedhjet e fundit parlamentare u mbajtën në dhjetor të vitit 2016 dhe rezultuan me përpjekje të zgjatura për të formuar qeverinë. Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase – Partia Demokratike për Unitet Kombëtar Maqedonas (VMRO-DPMNE) fitoi numrin më të madh të deputetëve, por nuk ishte në gjendje të formojë qeveri pasi Bashkimi Demokratik për Integrimin (BDI) dhe partitë e tjera të shqiptarëve etnikë e mbështetën Lidhjen Social Demokratike të Maqedonisë (LSDM). Pas një periudhe të trazirave intensive politike, gjatë të cilës kryetari i shtetit, Gjorge Ivanov, refuzoi t'ia jepte LSDM-së mandatin për të formuar qeveri, më në fund, më 31 maj 2017 u krijua një qeveri e udhëhequr nga LSDM-ja.³

Anëtarësimi i vendit në Bashkimin Evropian (BE) dhe në Organizatën e Traktatit të Atlantikut Verior (NATO) është penguar historikisht si rezultat i mungesës së konsensusit në mesin e vendeve anëtare të këtyre organizatave për shkak të kontestit në lidhje me emrin e vendit. Më 17 qershor 2018, pas një viti negociatash intensive nën patronazhin e Kombeve të Bashkuara, vendi nënshkroi marrëveshje bilaterale me Greqinë. Marrëveshja parashihet ndryshime kushtetuese të cilat do të përfshinin ndryshimin e emrit të vendit në “Republika e Maqedonisë Veriore”.⁴ Implementimi i Marrëveshjes konsiderohet si parakusht për integrimin në BE dhe NATO.⁵

Vendimi për të mbajtur referendum konsultativ për miratimin e marrëveshjes u miratua në Kuvend më 30 korrik me shumicë të thjeshtë, pa arritur konsensus mbi formulimin e pyetjes që do të vendoset dhe natyrën ligjërisht të detyrueshme të referendumit.⁶ Pas referendumit, për ndryshimet kushtetuese do të nevojiteshin ende një sërë miratimesh parlamentare, duke përfshirë edhe votimin përfundimtar me

² Shih [raportet e mëparshme të ODIHR-it për vendin](#).

³ Parlamenti përbëhet nga 120 deputetë, nga të cilët 51 janë të VMRO-DPMNE-së, 49 të LSDM-së, 10 të BDI-së, 5 të Lëvizjes BESA, 3 të Koalicioni "Aleanca për shqiptarët" dhe 2 të Partisë Demokratike Shqiptare. Nga 120 deputetë, 45 janë gra. Pas një ndarjeje brenda Lëvizjes BESA, dy fraksione funksionojnë si subjekte të veçanta nën emrin e partisë.

⁴ Shih [tekstin e plotë të marrëveshjes](#).

⁵ Në nenin 2 të marrëveshjes, Greqia obligohet "të mos e pengojë aplikimin ose anëtarësimin e Palës së dytë [nën emrin "Republika e Maqedonisë Veriore"] në organizatat dhe institucionet ndërkombëtare, multilaterale dhe rajonale në të cilat është anëtare Pala e parë". Në samitin e saj në korrik të vitit 2018, NATO-ja i bëri [ftesë zyrtare vendit që t'i fillojë negociatat për anëtarësim](#). BE-ja ngjashëm ka bërë me dije se [fillimi i bisedimeve për anëtarësim është i lidhur me zgjidhjen e kontestit të emrit](#).

⁶ Vendimi për mbajtjen e referendumit kaloi me 69 vota në Kuvendin me 120 deputetë dhe pa vota kundër. Përfaqësuesit e VMRO-DPMNE-së nuk morën pjesë në votim. Për mbajtjen e referendumit votuan përfaqësuesit e LSDM-së, BDI-së dhe të Lëvizjes BESA.

shumicë votash prej dy të tretave.⁷ Sapo të miratoheshin amendamentet, ishte e nevojshme që marrëveshja të miratohej nga parlamenti i Greqisë.

IV. KORNIZA LIGJORE

Referendumi kryesisht është i rregulluar me Kushtetutën e vitit 1991 (e ndryshuar për herë të fundit në vitin 2011), Ligjin për referendumin dhe iniciativat qytetare të vitit 2015 (Ligji për Referendumin), dhe Kodin Zgjedhor të vitit 2006 (i ndryshuar për herë të fundit në korrik të vitit 2018).⁸ Në ligjet e tjera bëjnë pjesë Kodi Penal, Ligji për tubimet publike, Ligji për parandalimin e korrupsionit, Ligji për kontestet administrative, Ligji për mediat dhe Ligji për shërbime audio dhe audiovizuale mediatike. Vendi po ashtu i ka ratifikuar edhe instrumentet kryesore ndërkombëtare që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut dhe mbajtjen e zgjedhjeve demokratike.⁹

Korniza ligjore për referendumin nuk është as gjithëpërfshirëse dhe as e harmonizuar.¹⁰ Edhe pse Ligji për Referendumin i përcakton rregullat themelore për procesin e referendumit, ka mungesë të detajeve për disa çështje thelbësore, siç janë rregullat për zhvillimin e fushatës dhe financimin e fushatës, dhe është në kundërshtim me disa dispozita të Kodit Zgjedhor, si për shembull përbërja e Këshillave Zgjedhore, procedurat për zgjidhjen e kontesteve dhe prania e vëzhguesve partiakë në vendvotime. Ligji për Referendumin parasheh se dispozitat e Kodit Zgjedhor vlejné edhe për referendumin, nëse nuk është përcaktuar ndryshe. Megjithatë, edhe pse KSHZ-ja i zbatoi dispozitat e Kodit Zgjedhor për administratën zgjedhore dhe regjistrimin e zgjedhësve për referendumin, rregullat për financimin e fushatës dhe zhvillimin e fushatës nuk u zbatuan.¹¹ Përrjashtimi i këtyre fushave nga korniza ligjore shkaktoi konfuzion në mesin e palëve të interesuara sa i përket rregullave që duhet të zbatohen dhe e zvogëloi qartësinë ligjore.¹² Përrpjekjet e KSHZ-së për t'i plotësuar këto zbrazëtira dhe për t'i qartësuar çështjet e tjera

⁷ Ligji për Referendum kërkon mbajtjen e referendumit që është ligjërisht i detyrueshëm për anëtarësim në ndonjë lidhje ose aleancë ndërkombëtare. Qeveria e informoi MVR-në e ODIHR-it se do të nevojitet edhe një referendum tjetër përpara pranimit të mundshëm në BE. Një vendim i Kuvendit i vitit 1993, i riafirmuar më vonë në vitin 2012 dhe 2018, e miratoi anëtarësimin e mundshëm të vendit në NATO.

⁸ Në përputhje me rekomandimet e mëparshme të ODIHR-it dhe të Komisionit të Venedikut, qeveria, në konsultim me shoqërinë qytetare dhe partitë politike, ka ndërmarrë hapa për ta reformuar legjisllacionin zgjedhor, mirëpo këto reforma akoma nuk janë realizuar.

⁹ Këtu bëjnë pjesë Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor e vitit 1965, Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike e vitit 1966, Konventa e OKB-së për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave e vitit 1979, Konventa e OKB-së kundër Korrupsionit e vitit 2003, dhe Konventa e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara e vitit 2006 (KDPK), dhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut e vitit 1950. Vendi po ashtu është anëtar i Komisionit të Venedikut të Këshillit të Evropës dhe i Grupit të Shteteve kundër Korrupsionit (GRECO).

¹⁰ Rregullat e KSHZ-së për këtë referendum theksuan se Ligji për Referendumin nuk është i harmonizuar me Kodin zgjedhor.

¹¹ Ligji për Referendumin nuk përcakton në detaje se çka nënkupton zhvillimi i fushatës dhe të drejtat e individëve dhe të subjekteve për të zhvilluar fushatë. KSHZ-ja i sqaroi MVR-së së ODIHR-it se termi “fushatë zgjedhore” në Kodin zgjedhor ka të bëjë me kandidatët dhe partitë politike dhe për këtë arsye nuk vlen për aktivitetet e fushatës së referendumit.

¹² Për shembull, KSHZ-ja dhe Agjencia për shërbime audio dhe audio-vizuale mediatike dhanë udhëzime kundërthënëse (shih seksionin *Mediat*). Përveç kësaj, KSHZ-ja pranoi letra ku kërkohej qartësim për zbatueshmërinë e Kodit Zgjedhor dhe Ligjit për financimin e partive politike në lidhje me zhvillimin e fushatës nga të huajt, praninë e vëzhguesve të partive politike dhe përdorimin e llogarive të veçanta për financimin e fushatës, në të cilat KSHZ-ja u përgjigj se dispozitat përkatëse të ligjeve përkatëse nuk ishin të zbatueshme.

nëpërmjet rregulloreve ngritën pyetje në lidhje me bazën e tyre ligjore dhe për diapazonin e kompetencës rregullatore të KSHZ-së.¹³

Korniza ligjore për referendumet duhet të rishikohet dhe të harmonizohet me Kodin zgjedhor. Në veçanti, Ligji për Referendumin duhet të ndryshohet për të përfshirë dispozita mbi fushatën dhe financimin e fushatës, që do të jenë specifike për referendumet.

Ligji për Referendumin parasheh që çështja për të cilën vendoset “të jetë e formuluar saktë dhe në mënyrë të padyshimtë, që qytetarët të mund të përgjigjen me ‘Për’ ose ‘Kundër’”. Pyetja në fletëvotim ishte “A jeni për anëtarësim në BE dhe NATO duke e pranuar Marrëveshjen ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Greqisë?”. Disa bashkëbisedues të MVR-së së ODIHR-it theksuan se natyra komplekse e pyetjes, si dhe mungesa e përmendjes së qartë të ndryshimit të emrit kushtetues të vendit dhe amendamentet e tjera të nënkuptuara kushtetuese, mund t’i çorientojë votuesit. Palë të tjera të interesuara theksuan se kishte lidhje të drejtpërdrejta ndërmjet pjesëve të ndryshme të pyetjes, siç u dëshmuua nga pohimet publike të zyrtarëve të BE-së dhe të NATO-s se marrëveshja është parakusht për integrimin.¹⁴ Asnjë institucion jo-partiak nuk është i ngarkuar me shqyrtimin e pyetjeve të dorëzuara nga Kuvendi për t’u votuar në referendum.¹⁵ Megjithatë, në përgjigje të kundërshtimeve, Gjykata Kushtetuese e shqyrtoi vendimin për mbajtjen e referendumit, duke përfshirë edhe formulimin e pyetjes. Në dëgjimin publik më 19 shtator, Gjykata i diskutoi dobësitë në formulimin e pyetjes, por një mendim i mëpasshëm me shkrim deklaroi se pyetja ishte në përputhje me kërkesat ligjore për qartësi, dhe Gjykata nuk ndërmori veprime të mëtejshme (shih seksionin *Kundërshtimet dhe Ankesat*).

Duhet konsideruar mundësia për ta autorizuar një organ të paanshëm që të rishikojë në kohë çdo pyetje të propozuar për referendum, për të siguruar qartësi dhe ligjshmëri.

Ligji kërkon një kufi të pjesëmarrjes prej shumicës së votuesve të regjistruar që referendumi të konsiderohet i miratuar, mirëpo nuk thekson në mënyrë eksplicite nëse ky kufi i pjesëmarrjes vlen edhe për referendumin konsultativ.¹⁶ Duke pasur parasysh natyrën konsultative, qeveria nuk identifikoi kritere *de facto*, si për shembull kufirin e pjesëmarrjes së zgjedhësve ose përqindjen e votave ‘Për’, në bazë të të cilave do të vazhdonte ose nuk do të vazhdonte me amendamentet e propozuara kushtetuese në Kuvend pas referendumit. Kryeministri, ministri i punëve të jashtme dhe kryetari i Kuvendit theksuan se me

¹³ Për shembull, rregullativa e KSHZ-së përcaktoi që Kuvendit t’i ndahet hapësirë e veçantë në media për fushatën, dhe kundërshtimet lidhur me regjistrimin e zgjedhësve i transferoi në kompetencë të Gjykatës Supreme. Gjykata Supreme më vonë vendosi se nuk kishte bazë ligjore për këtë ndryshim të juridiksionit. Paragrafi VIII.18. i [Dokumenti të Budapestit të OSBE-së të vitit 1994](#) thekson se “vendet pjesëmarrëse potencojnë se të gjitha veprimet e autoriteteve publike duhet të jenë në përputhje me sundimin e ligjit, duke e garantuar kështu sigurinë ligjore për individin”. Seksioni II.2.a. i [Kodit të praktikës së mirë për referendumet i Komisionit të Venedikut i vitit 2007](#) rekomandon që “përveç rregullave mbi çështjet teknike dhe detajet (të cilat mund të përfshihen në rregulloret e pushtetit ekzekutiv), rregullat e ligjit për referendum duhet të kenë të paktën gradën e statutit”.

¹⁴ Seksioni III.2. i [Kodi i praktikës së mirë për referendumet](#) rekomandon që pyetja të mos jetë çorientuese dhe të mos sugjerojë ndonjë përgjigje, dhe se “duhet të ketë një lidhje të brendshme midis pjesëve të çdo pyetjeje që hidhet për votim me qëllim që të garantohet votimi i lirë i votuesit, nga i cili nuk duhet të kërkohej ta pranojë ose ta refuzojë dispozitën si të tërë, pa pasur një lidhje të brendshme.”

¹⁵ Neni 20 i Ligjit për Referendum përcakton se vendimi për mbajtjen e referendumit shtetëror merret nga Kuvendi, ndërsa neni 9 kërkon që ky vendim ta përfshijë edhe propozimin për të cilin do të votojnë qytetarët.

¹⁶ Neni 8 i Ligjit për Referendum bën dallim ndërmjet referendumit ligjërisht të detyrueshëm për “vendosje” dhe referendumit jo të detyrueshëm për “konsultim”, kurse neni 30.1 thekson se nevojitet kuorum i shumicës së votuesve të regjistruar që “vendimi të konsiderohet i miratuar”. Seksioni III.7.a. i [Kodi të praktikës së mirë për referendumet](#) këshillon që të mos parashihet “një kuorum i pjesëmarrjes (kufi, përqindje minimale), pasi që i bashkon zgjedhësit që abstenojnë me ata që votojnë kundër”.

amendamentet do të vazhdohet pa marrë parasysh pjesëmarrjen e zgjedhësve në referendum, në qoftë se shumica e votave janë 'Për'. Megjithatë, fushata për bojkot e potencoi rëndësinë e kufirit të pjesëmarrjes për rezultatin e referendumit dhe më 3 tetor KSHZ-ja njoftoi se "vendimi nuk është miratuar sepse më shumë se gjysma e numrit të përgjithshëm të qytetarëve të regjistruar në listën e votuesve nuk kanë votuar" (shih seksionin *Shpallja e rezultateve*). Këto interpretime të ndryshme të kufirit të pjesëmarrjes krijuan paqartësi në lidhje me pasojat procedurale të votimit.¹⁷

Zbatimi i kriterit të kufirit të pjesëmarrjes së zgjedhësve për referendumet konsultative duhet të qartësohet në ligj.

V. ADMINISTRIMI I REFERENDUMIT

Referendumi u administrua nga administrata në tre nivele, që përbëhej nga KSHZ-ja, 80 KZK dhe Komisioni zgjedhor për Qytetin e Shkupit, dhe 3.480 Këshilla Zgjedhorë (KZ).¹⁸ Përveç kësaj, u krijuan edhe 33 KZ në Përfaqësitë diplomatike-konsullore për votimin jashtë vendit, dhe një KZ shtesë në KSHZ për ta administruar votimin e anëtarëve të KZ-ve që ishin shpërndarë në detyra diplomatike.

Duke u larguar nga praktika e mirë, me ndryshimet e fundit të Kodit Zgjedhor të bëra në korrik të vitit 2018 u krijua KSHZ e përkohshme me mandat gjashtëmuor.¹⁹ Të gjithë shtatë anëtarët (tre gra) u emëruan nga partitë parlamentare politike: katër nga koalicioni në pushtet, duke përfshirë nënkryetarin, dhe tre nga opozita, duke përfshirë kryetarin.²⁰ Kodi Zgjedhor parasheh emërimin e zëvendës-sekretarit të përgjithshëm të KSHZ-së, mirëpo kjo pozitë nuk u definua dhe as nuk u plotësua para se të mbahej referendumi.

Kuvendi duhet të miratojë dispozita për Komision të përhershëm Shtetëror të Zgjedhjeve, për të siguruar stabilitet dhe qëndrueshmëri në administrimin e proceseve zgjedhore.

KSHZ-ja e administroi referendumin në mënyrë të paanshme dhe në përgjithësi iu përmbajt afateve ligjore. Komisioni mbajti mbledhje të rregullta publike të cilat u zhvilluan në mënyrë efikase dhe kolegjinale. Megjithatë, në mbledhjet publike kishte mungesë të debatit përmbajtësor, me ç'rast vendimet u miratuan në mënyrë unanime pas takimeve paraprake të punës, të cilat nuk ishin të hapura për publikun e as për vëzhguesit.²¹ Edhe pse KSHZ-ja e publikoi shumicën e vendimeve të saj dhe informatat kyçe në

¹⁷ Seksioni III.8.a. i [Kodit të praktikës së mirë për referendumet](#) këshillon që "efektet e referendumeve ligjërish të detyrueshme ose atyre konsultative duhet të specifikohen qartë në Kushtetutë ose me ligj".

¹⁸ Më 14 shtator, KSHZ-ja publikoi një listë me 81 vendvotime të vendosura në 27 komuna me më pak se 10 zgjedhës të regjistruar. KZK-të nuk emëruan anëtarë të KZ-ve për këto vendvotime por i shpërndanë këta votues në vendvotimet më të afërta. Megjithatë, rezultatet e këtyre vendvotimeve u regjistruan në protokolle të veçanta, gjë që ka mundur eventualisht ta shkelë fshehtësinë e votës për shkak të numrit shumë të vogël të votuesve.

¹⁹ Seksioni II.3.1.c i [Kodit të praktikës së mirë për referendumet](#) dhe II.3.1.c. i [Kodit të praktikës së mirë të Komisionit të Venedikut në çështjet zgjedhore të vitit 2002](#) rekomandojnë që komisioni qendror të ketë karakter të përhershëm. Anëtarët e mëparshëm të KSHZ-së dhanë dorëheqje në janar të vitit 2018 pas një skandali të korrupsionit. Pas referendumit, Kuvendi e zgjati mandatin e KSHZ-së aktuale edhe për më shumti dy vjet.

²⁰ Tre anëtarë kishin përvojë të mëparshme me administratën zgjedhore, duke përfshirë një ish-kryetar të KSHZ-së.

²¹ Sipas KSHZ-së, në këto takime pune u vlerësua implementimi i kalendarit të aktiviteteve dhe u arrit konsensus për propozim-vendimet dhe raportet e përgatitura nga punonjësit profesionalë. Neni 32.2 i Ligjit për Referendum dhe neni 24 i Kodit Zgjedhor kërkojnë që puna e KSHZ-së të jetë publike, në përputhje me seksionin 3.1 të [Kodit për praktikë të mirë në çështjet zgjedhore](#).

ueb-faqen e saj, jo të gjitha vendimet u publikuan, gjë që nuk është në përputhje me rregulloren e brendshme të KSHZ-së dhe me standardet ndërkombëtare.²²

Të gjitha vendimet e KSHZ-së për procedurat e tenderimit për përzgjedhjen e kontraktuesve u morën në mbledhje të mbyllura të Komisionit për furnizime të KSHZ-së, dhe buxheti i përgjithshëm nuk është dokument publik.²³ Kjo praktikë është në kundërshtim me kërkesën ligjore që disa aspekte të procedurës së tenderimit të realizohen publikisht dhe me kërkesën e përgjithshme që puna e KSHZ-së të jetë publike.²⁴

Për ta rritur besimin e publikut dhe në përputhje me ligjin, Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve duhet të sigurojë që të gjitha informatat në lidhje me zgjedhjet që janë me interes publik, duke i përfshirë vendimet dhe procedurat e prokurimit, të bëhen publike në kohë.

KZK-të ishin të përbëra nga pesë anëtarë (dhe zëvendës), dhe ishin zgjedhur në mënyrë të rastësishme nga radhët e nëpunësve publikë. KZK-të e mbikëqyrën administrimin e referendumit në çdo komunë, i emëruan dhe i trajnuan KZ-të, dhe i menaxhuan përgatitjet e tjera teknike. KZ-të përbëheshin nga tre anëtarë (dhe zëvendës), të cilët u zgjodhën në mënyrë të rastësishme nga radhët e nëpunësve publikë dhe ishin përgjegjëse për menaxhimin e vendvotimeve dhe zhvillimin e votimit dhe procedurat e numërimit të votave.²⁵ Për referendumin, KZ-të nuk përfshinin dy anëtarë të përkohshëm të emëruar nga partitë, siç parashihet në Kodin Zgjedhor për rastin e zgjedhjeve. Përkundër disa ndryshimeve të vonshme në përbërjen e KZK-ve dhe KZ-ve, kërkesa për përfaqësim të balancuar etnik dhe gjinor në komisionet zgjedhore u respektua gjerësisht.²⁶ Në dy të tretat e KZ-ve të vëzhguara kryetaret ishin gra.

Komisionet e nivelit më të ulët, në përgjithësi, punuan në mënyrë profesionale dhe e gëzuan besimin e palëve të interesuara lokale. Megjithatë, edhe pse mbledhjet e shumicës së KZK-ve ishin publike, në disa raste të pakta ato nuk u lajmëruan paraprakisht, gjë që e vështirësoi vëzhgimin.²⁷ Një numër i KZK-ve e informuan MVR-në e ODIHR-it për kompensime të papaguara për vitin 2016 dhe 2017, dhe shumë prej

²² Megjithëse neni 76 i rregullores së brendshme të KSHZ-së kërkon që të gjitha aktet e miratuara nga KSHZ-ja të publikohen në ueb-faqen e saj, u publikuan vetëm 27 nga 42 vendime të tilla. Paragrafi 19 i [Komentit të përgjithshëm i KDPC-së nr. 34 për nenin 19 të KNDCP-së të vitit 2011](#) kërkon që “për ta mundësuar ushtrimin e të drejtës për qasje në informata, shtetet palë duhet t’i fusin në domenin publik në mënyrë proaktive informatat e qeverisë me interes publik. Shtetet palë duhet të bëjnë çdo përpjekje për të siguruar qasje të lehtë, të shpejtë, efektive dhe praktike në këto informata”.

²³ Prokurimet e KSHZ-së për referendumin u kryen nëpërmjet procedurës me negociatë, pa publikuar paraprakisht shpallje të kontratës. MVR-ja e ODIHR-it mundi të merrte pjesë në seancën e fundit të prokurimit ku, kontraktuesit e përzgjedhur, i paraqitën ofertat e tyre për furnizimin e fletëvotimeve, listave të votuesve, protokolleve dhe kabinave të votimit.

²⁴ Neni 136 i Ligjit për furnizime publike thekson se “hapja e ofertave te procedura e hapur, te faza e dytë nga procedura e kufizuar dhe te faza e dorëzimit të ofertave nga dialogu i konkurrencës është publik”. Neni 32(2) i Ligjit për Referendum thotë se “puna e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve është publike”. Shih po ashtu nenin 24 të Kodit Zgjedhor dhe nenin 3.1. të [Kodit të praktikës së mirë në çështjet zgjedhore](#).

²⁵ Anëtarët e KZK-ve dhe të KZ-ve u emëruan me mandat pesëvjeçar dhe katërvjeçar, respektivisht, në vitin 2016 dhe 2017.

²⁶ Kodi Zgjedhor përcakton se bashkësitë etnike që përbëjnë më shumë se 20 për qind të popullsisë në një komunë duhet të përfaqësohen në KZK dhe KZ, ndërsa së paku 30 për qind e anëtarëve në të gjitha organet zgjedhore duhet të jenë nga secila gjini.

²⁷ Për shembull, mbledhjet e KZK-së në Butel ishin të hapura vetëm për vëzhguesit e akredituar, nëse kjo kërkohej me njoftim paraprak. Mbledhjet e KZK-së në Aerodrom ishin të mbyllura dhe procesverbalet nuk u publikuan, mirëpo vendimet u publikuan në buletin e komunës. Procesverbalet e mbledhjeve të KZK-së së Zërnovcit nuk iu dhanë vëzhguesve të MVR-së së ODIHR-it.

tyre u ankuan se gjatë ndarjes së mjeteve financiare nuk është marrë parasysh numri i vendvotimeve dhe largësia ndërmjet vendvotimeve në secilën komunë.

KSHZ-ja mbajti trajnime kaskadore për komisionet zgjedhore të nivelit më të ulët, duke përdorur prezantime, doracakë dhe video. Megjithatë, KSHZ-ja u vonua me mbajtjen e trajnimeve për KZK-të dhe vendosi t'i bashkojë ato me trajnimin e trajnuesve. Trajnimet e KZK-ve që u vëzhguan nga MVR-ja e ODIHR-it ishin të organizuara mirë, interaktive, dhe u mbajtën edhe në gjuhën maqedonase edhe në gjuhën shqipe atje ku kishte nevojë.²⁸ Trajnimet e KZ-ve që u vëzhguan nga MVR-ja e ODIHR-it ishin më pak të organizuara dhe me cilësi më të dobët. Doracakët për trajnim ishin në dispozicion vetëm për trajnimin e anëtarëve të KZ-ve.

Udhëzimit të KSHZ-së për vlefshmërinë e fletëvotimeve i mungonte qartësia dhe nuk ishte në përputhje me doracakun e trajnimit dhe me Kodin Zgjedhor.²⁹ Udhëzimi urdhëroi përdorimin e një stilolapsi të kaltër dhe rrethin si mënyra të vetme të vlefshme për ta shënuar fletëvotimin, por gjithashtu theksoi se “fletëvotimi duhet të konsiderohet i vlefshëm nëse mund të përcaktohet në mënyrë të sigurt dhe të padyshimtë se për cilën nga përgjigjet e ofruara ka votuar votuesi”.³⁰ Doracakun e trajnimit i udhëzoi anëtarët e komisionit se çdo fletëvotim që nuk është i shënuar me ngjyrë të kaltër dhe rreth është i pavlefshëm, pavarësisht nëse qëllimi i votuesit është i qartë.³¹

Rregullat për procedurat e ditës së votimit, duke i përfshirë edhe ato për interpretimin e qëllimit të votuesit, duhet të jenë në përputhje me legjislacionin dhe duhet të miratohen para finalizimit të mjeteve për trajnim. Trajnimi për anëtarët e Këshillave Zgjedhore mund të përqendrohet më shumë në numërimin e votave, me hollësi të mëtejshme për protokollin e rezultateve dhe procedurat e harmonizimit të rezultateve.

Pozitivisht, në përputhje me një rekomandim të mëparshëm të ODIHR-it, KSHZ-ja zhvilloi një fushatë të avancuar për informimin e zgjedhësve, duke përfshirë përmbajtje televizive dhe onlajn, pjesa më e madhe e të cilës kishte për synim votuesit e rinj. Materiali u fokusua në procedurat e ditës së referendumit dhe si të gjenden vendvotimet, dhe u potencua liria e zgjedhjes dhe pjesëmarrja, në vend të inkurajimit të daljes në referendum. Materiali ishte në dispozicion edhe në gjuhët e pakicave, por nuk u prodhua në formate të qasshme për individët me dëgjim ose shikim të dëmtuar. Edhe pse u përdor një numër impresiv i tipareve të sigurisë për prodhimin e fletëvotimeve të referendumit, KSHZ-ja nuk e njoftoi elektoratin se çfarë dobie do të kishte integriteti i procesit nga kjo risi.

Autoritetet bënë disa përpjekje për të ofruar informacion neutral në lidhje me çështjen që duhej të vendoset në referendum.³² Megjithatë, thelbi i marrëveshjes dhe ndikimi potencial i saj nuk u sqaruan sa

²⁸ Kodi Zgjedhor kërkon që materialet e votimit në vendvotime të jenë në dispozicion në gjuhët e pakicave që fliten nga të paktën 20 përqind e popullsisë përkatëse.

²⁹ Neni 115 i Kodit Zgjedhor thekson se fletëvotimi duhet të konsiderohet i vlefshëm nëse qëllimi i votuesit mund të përcaktohet në mënyrë të sigurt dhe të padyshimtë.

³⁰ Udhëzimi i KSHZ-së 08-1930/1 i datës 14 shtator 2018.

³¹ Seksioni I.3.2.2.4 i [Kodit të praktikës së mirë në çështjet zgjedhore](#) këshillon se “në rast dyshimi, duhen bërë përpjekje për të mësuar se cili ka qenë qëllimi i votuesit”.

³² Paragrafi 11 i [Komentit të përgjithshëm 25 të KDNJ-së së KB-ve të vitit 1996](#) thekson se “fushatat për edukimin dhe regjistrimin e votuesve janë të nevojshme për të siguruar ushtrimin efektiv të të drejtave të nenit 25 nga një bashkësi e informuar”. Seksioni I.3.1. i [Kodit të praktikës së mirë për referendumet](#) thekson se “autoritetet duhet të ofrojnë informacion objektiv”, dhe se “materialet nga mbështetësit dhe kundërshtuesit duhet të jenë në dispozicion për votuesit një kohë të mjaftueshme përpara votimit”.

duhet ose u sqaruan shumë vonë në fushatë.³³ Mediat transmetuese kryesisht e plotësuan këtë zbrazëti duke ofruar programe informative në lidhje me marrëveshjen dhe referendumin, që e përmirësoi aftësinë e votuesve për të marrë vendim në bazë të informatave (shih seksionin *Mediat*).

VI. REGJISTRIMI I VOTUESVE

Qytetarët që kanë mbushur 18 vjet kanë të drejtë vote, përveç atyre që u është hequr kjo e drejtë ligjore me vendim gjyqësor. Heqja e të drejtës së votës në bazë të paaftësisë mendore ose intelektuale është në kundërshtim me standardet ndërkombëtare.³⁴

Legjislacioni duhet të harmonizohet me qëllimet e Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, duke i hequr të gjitha kufizimet e të drejtës së votës në bazë të aftësisë së kufizuar mendore ose intelektuale.

Regjistrimi i votuesve për votimin brenda vendit është pasiv, ndërsa votuesit duhet të regjistrohen në mënyrë aktive (me vetdëshirë) për votim jashtë vendit. Që nga viti 2015, KSHZ-ja është organi i vetëm që ka përgjegjësi ligjore për përditësimin e listës së votuesve. Megjithatë, në praktikë, lista e votuesve për referendumin u mirëmbajt nga Enti Shtetëror i Statistikave, të cilit KSHZ-ja i dërgonte përditësime nga Ministria për Punë të Brendshme (MPB), gjykatat dhe institucionet e tjera. Gjatë këqyrjes publike të listave zgjedhore që u bë prej datës 9 deri më 23 gusht, gjithsej 5.641 votues i kontrolluan të dhënat e tyre personale në listën e votuesve.³⁵ KSHZ-ja e mbylli listën zgjedhore më 7 shtator dhe lista përfundimtare përfshinte 1.806.336 zgjedhës me të drejtë vote.³⁶ Disa afate për dorëzimin e të dhënave në KSHZ erdhën pas përfundimit të periudhës së inspektimit publik, gjë që e cenoi mundësinë e zgjedhësve me të drejtë vote për t'i kontrolluar të dhënat e tyre.

Ndarja e detyrave dhe përgjegjësiive për mirëmbajtjen e regjistrit të votuesve duhet të qartësohet dhe të zbatohet, dhe afatet për përditësimet duhet të rishikohen, për të siguruar inkluzivitet dhe saktësi.

Në bazë të Kodit Zgjedhor, vetëm personat me adresë të paraqitur dhe me letërnjoftim ose me pasaportë biometrike të vlefshme ishin përfshirë në listën e votuesve. Përkundër rekomandimit paraprak të ODIHR-it, Kodi Zgjedhor dhe Ligji për paraqitjen e vendbanimit dhe vendqëndrimin vazhdojnë të kenë definicione kontradiktore të vendbanimit dhe të vendqëndrimin të qytetarëve që jetojnë në vend dhe jashtë vendit. Disa bashkëbisedues të MVR-së së ODIHR-it i përshkruan mangësitë që lidhen me mungesën e një regjistri të unifikuar kombëtar të adresave, duke përfshirë edhe mungesën e harmonizimit të të

³³ Për shembull, disa bashkëbisedues të MVR-së ODIHR-it u shprehën se ishte e paqartë nëse çështja e integritetit ishte propozim i pyetjes së referendumit aktual apo se do të mbahet një referendum tjetër për anëtarësimin në BE, siç kërkohet me ligj.

³⁴ Nenet 12 dhe 29 të [KDKPAK-së të vitit 2006](#). Shih gjithashtu paragrafin 9.4 të [Komunikatës Nr. 4/2011 të Komisionit të KDKPAK-së të vitit 2013](#), ku thuhet se “Neni 29 nuk parasheh asnjë kufizim të arsyeshem, e as që lejon ndonjë përjashtim për cilin do grup personash me aftësi të kufizuara. Prandaj, përjashtimi i të drejtës për të votuar në bazë të paaftësisë së perceptuar ose aktuale psikosociale ose intelektuale, duke përfshirë kufizimin në bazë të një vlerësimi të individualizuar, përbën diskriminim në bazë të aftësisë së kufizuar, në kuptim të nenit 2 të Konventës”. Paragrafi 41.1 i [Dokumentit të Moskës së OSBE-së të vitit 1991](#) i obligon vendet pjesëmarrëse “të sigurojnë mbrojtje të të drejtave të njeriut të personave me aftësi të kufizuara”.

³⁵ Zgjedhësit kishin mundësi t'i kontrollojnë të dhënat e tyre personalisht në KZK. Sipas KSHZ-së, këqyrja publike rezultoi me 94 shtime të reja, 295 fshirje dhe 74 korrigjime.

³⁶ Ky numër i përfshin 2,694 persona të regjistruar për të votuar jashtë vendit në 28 misione diplomatike.

dhënave ndërmjet të gjitha institucioneve që përpilojnë të dhëna të vendbanimit.³⁷ Përveç kësaj, palët e interesuara e informuan MVR-në e ODIHR-it se dëshmia e vendbanimit nuk u zbatua në mënyrë të vazhdueshme për lëshimin dhe rinovimin e letërnjoftimeve dhe pasaportave, e cila u përkeqësua për shkak të mosraportimit nga qytetarët gjatë përditësimit të vendbanimit të tyre të vërtetë, duke përfshirë edhe atë jashtë vendit. Mungesa e përditësimeve të të dhënave të adresës në letërnjoftime mund të ketë ndikuar në shpërndarjen e pastajme të votuesve nëpër vendvotime, edhe pse gjatë votimit u vunë re pak raste të tilla (shih seksionin *Dita e referendumit*).³⁸ Pozitivisht, duke vepruar në bazë të një rekomandimi të mëparshëm të ODIHR-it, autoritetet filluan një operacion *ad hoc* për rinovimin e dokumenteve me afat të kaluar të personave të mbyllur në burgje.³⁹ Përkundër çështjeve prej një kohe të gjatë që kanë të bëjnë me përpunimin dhe saktësinë e të dhënave të regjistrimit të votuesve, integriteti i listës së votuesve nuk u përmend si shqetësim kryesor nga bashkëbiseduesit e MVR-së së ODIHR-it.

Krijimi i regjistrimit të përhershëm kombëtar të adresave duhet të jetë prioritet, me ç'rast harmonizimi i të dhënave të vendbanimit duhet të jetë i definuar qartë.

VII. FUSHATA E REFERENDUMIT

Periudha zyrtare e fushatës filloi më 30 korrik, në ditën e shpalljes së datës së referendumit. Megjithatë, shumica e palëve të interesuara i intensifikuan aktivitetet e tyre të fushatës pas 10 shtatorit.⁴⁰ Fushata përfundoi 48 orë para datës së referendumit dhe në përgjithësi ishte paqësore dhe aktive anëmbanë vendit. Nuk kishte kufizime të të drejtave themelore që kanë të bëjnë me fushatën, duke i përfshirë të drejtat për tubim, bashkim dhe shprehje.⁴¹

Ligji për Referendum nuk kërkon që pjesëmarrësit të regjistrohen që të mund të zhvillojnë fushatë. Ligji parasheh se vetëm propozuesi i autorizuar i referendumit, në këtë rast Kuvendi, mund të zhvillojë fushatë zyrtare, por nuk i rregullon aktivitetet e fushatës të cilit do qoftë aktori tjetër.⁴²

Partia në pushtet, LSDM-ja, u bashkua me mbi 100 organizata të shoqërisë civile për ta përkrahur votën 'Për', me mesazhin "Dil për Maqedoninë Evropiane". Fushata 'Për' ishte e dukshme anëmbanë vendit dhe e fokusuar në dobitë e anëtarësimit në BE dhe NATO, veçanërisht për gjeneratën më të re. Mënyrat e

³⁷ Dispozitat ligjore që e rregullojnë regjistrin e adresave, duke përfshirë edhe përditësimin e shënimeve, fshirjen e adresave të skaduar dhe parandalimin e regjistrimit në adresa me dëshmi të pamjaftueshme, janë të paharmonizuara. Autoritetet e informuan MVR-në e ODIHR-it për planet për reformimin e regjistrimit të adresave në vitin 2019, duke përfshirë standardizimin e kodimit, emërtimit dhe numërimit të rrugëve, si një komponente e një përpjekjeje më të gjerë nga Ministria për Shoqëri Informatike dhe Administratë për të krijuar një regjistër të përhershëm kombëtar të popullsisë. Paragrafi 11 i [Komentit të përgjithshëm i KDPC-së nr. 25 për nenin 25 të KNDCP-së të vitit 1996](#) thekson se "Shtetet duhet të marrin masa efektive për të siguruar se të gjithë personat me të drejtë vote të mund ta ushtrojnë këtë të drejtë".

³⁸ Megjithëse e ka kompetencën ligjore për ta bërë këtë, KSHZ-ja nuk i verifikoi shënimet në listën e votuesve përmes kontrollimeve të kryqëzuara të bazave të të dhënave të MPB-së dhe të institucioneve të tjera.

³⁹ Kjo iniciativë rezultoi me lëshimin e 260 letërnjoftimeve të reja. Propozim-ligji i ri për zbatimin e sanksioneve propozon zgjidhje të përhershme për çështjen e rinovimit të letërnjoftimeve të personave të burgosur.

⁴⁰ Kjo datë përputhet me fillimin e pushimit të deputetëve, e po ashtu mundëson 20 ditë për zhvillimin e fushatës, në përputhje me nenin 69-a(2) të Kodit Zgjedhor.

⁴¹ Përfaqësuesit e partisë jashtë-parlamentare "Maqedonia e Bashkuar" e informuan MVR-në e ODIHR-it se kompanitë reklamuese refuzuan t'i vendosin bilbordet e tyre.

⁴² Ligji për Referendum parasheh se "propozuesi i autorizuar" i referendumit kombëtar mund të jetë Kuvendi ose një grup prej 150.000 qytetarësh.

fushatës përfshinin shpërndarje të broshurave, bilborde, posterë, vizita derë-më-derë, si dhe tubime dhe tribuna.⁴³ Fushata u zhvillua edhe në platformat e mediave sociale.

Për dallim nga Kodi Zgjedhor, Ligji për Referendum nuk e rregullon përfshirjen e funksionarëve publikë ose përdorimin e mjeteve publike në fushatë. Kryeministri, ministrat dhe deputetët morën pjesë aktive në fushatën ‘Për’, dhe shpeshherë ishin të shoqëruar nga kryetarët e komunave në ngjarjet lokale të fushatës.⁴⁴

Korniza ligjore për zhvillimin e fushatave të referendumit duhet të ndryshohet për të përfshirë rregulla të qarta për zhvillim të fushatës, duke përfshirë edhe pjesëmarrjen e funksionarëve publikë.

Fushata kishte një shkallë të lartë të përfshirjes ndërkombëtare, me liderë të huaj dhe përfaqësues të nivelit të lartë të BE-së, Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të NATO-s, që e vizituan Shkupin për ta promovuar marrëveshjen bilaterale dhe për ta inkurajuar pjesëmarrjen në referendum.⁴⁵ Pothuajse të gjithë këta zyrtarë e kategorizuan marrëveshjen si “historike” dhe miratimin e saj si parakusht për anëtarësim në BE dhe NATO, me ç’rast disa prej tyre e mbështetën votën ‘Për’ në mënyrë eksplicite.⁴⁶ Përveç kësaj, gjatë gjithë periudhës së fushatës së referendumit, Delegacioni i Bashkimit Evropian zhvilloi aktivitete të gjera për komunikim me komunitetin nën sloganin “Imagjino të ardhmen e përbashkët”, duke përfshirë reklama televizive dhe ngjarje publike anembanë vendit. Shumë bashkëbisedues të MVR-së së ODIHR-it u shprehën se nuk bëhet dallim ndërmjet aktiviteteve ndërkombëtare dhe fushatës kombëtare ‘Për’, dhe si rezultat i kësaj ajo kishte publicitet më të madh (shih seksionin *Mediat*).

Përkundër faktit se bashkëbiseduesit e MVR-së së ODIHR-it nga bashkësitë dhe partitë e pakicave e konfirmuan mbështetjen e tyre për referendumin dhe i inkurajuan pasuesit e tyre që të votojnë ‘Për’, fushata në këto bashkësi ishte e qetë. Shumica e partive etnike shqiptare, turke dhe rome zhvilluan fushata të ndara me mesazhe që u dedikoheshin bashkësive të tyre përkatëse. Më e madhja prej tyre, BDI-ja, në raste të caktuara i koordinoi aktivitetet e saj me LSDM-në. Disa bashkëbisedues të MVR-së së ODIHR-it nga këto komunitete e kritikuan mungesën e materialeve të fushatës në gjuhët e pakicave, veçanërisht në zonat me popullsi boshnjake dhe turke.

Partia kryesore opozitare, VMRO-DPMNE, e dënoi marrëveshjen me Greqinë, të cilën e përshkroi si "kapitullim" dhe si kërcënim për identitetin dhe historinë e vendit. Megjithatë, kjo parti nuk mori qëndrim zyrtar në lidhje me referendumin, dhe më 11 shtator, kryetari i partisë njoftoi se qytetarët duhet “të veprojnë sipas ndërgjegjes së tyre”. Disa funksionarë aktualë dhe të mëparshëm të VMRO- DPMNE-së e kritikuan qëndrimin e partisë, me ç’rast disa e mbështetën publikisht pyetjen e referendumit dhe

⁴³ MVR-ja e ODIHR-it vëzhgoi gjithsej 45 tubime të fushatës “Për”, në mes tjerash, në: Manastir, Demir Hisar, Gostivar, Kriva Pallankë, Krushevë, Kumanovë, Ohër, Shtip, Strugë, Strumicë, Tetovë dhe Veles.

⁴⁴ Seksioni I.3.1. i [Kodit të praktikës së mirë për referendumet](#) thekson se edhe pse nuk është e domosdoshme të ndalohen ndërhyrjet e autoriteteve në referendum, ato nuk duhet të ndikojnë në rezultatin e votimit me anë të fushatës së tepërt dhe të njëanshme.

⁴⁵ Në mes tjerëve, Kancelarja gjermane, Kancelari austriak, Përfaqësuesi i Lartë i BE-së, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Sekretari i mbrojtjes i SHBA-ve dhe Ministri i mbrojtjes i Italisë.

⁴⁶ Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s tha publikisht gjatë [vizitës së tij në vend më 6 shtator](#): “E di se disa njerëz në vend mendojnë se mund të thonë ‘jo’ në referendum, por ‘po’ për anëtarësimin në NATO dhe BE. Nuk ka alternativë të tillë. Opsioni se Marrëveshja mund të refuzohet, e të anëtarësoheni në NATO, është iluzion”. Pjesëmarrësit e mbledhjes së Komisionit të përbashkët parlamentar të BE-së theksuan se marrëveshja i mundëson vendit të ecë më shpejt drejt integritimeve në BE dhe NATO.

inkurajuan të dilet në votim, ndërsa të tjerë theksuan se kanë ndërmend të votojnë kundër.⁴⁷ Edhe pse partia nuk zhvilloi fushatë zyrtare në lidhje me referendumin, ajo zhvilloi fushatë të vazhdueshme anti-qeveritare, e cila përfshiu marshe protestuese dhe përmbajtje në mediat sociale për t'i kritikuar politikat e qeverisë, duke e dënuar njëkohësisht marrëveshjen me Greqinë.

Edhe pse nuk kishte fushatë të organizuar 'Kundër', 72 shoqata qytetare dhe 2 parti politike jashtëparlamentare, "Maqedonia e Bashkuar" dhe "Zëri për Maqedoninë", u angazhuan për bojkot me qëllim që të pengonin që referendumi ta arrijë 50 për qind të kufirit të pjesëmarrjes së votuesve në të. Fushata për bojkot ishte aktive nëpërmjet tubimeve dhe në mediat sociale, dhe përdori gjuhë nacionaliste, e cila shpeshherë ishte nxitëse.⁴⁸ Rastet e dezinformative, disa prej të cilave gjoja të financuara nga aktorë të huaj, nuk u transmetuan nga mediat tradicionale transmetuese dhe diapazoni i tyre mbeti i kufizuar në hapësirën onlajn.⁴⁹ Kryetari i shtetit, i cili më parë refuzoi ta nënshkruajë ratifikimin e marrëveshjes nga Kuvendi, njoftoi se nuk do të votojë në referendum.⁵⁰ Duke pasur parasysh ndarjen në mes të fushatës 'Për' dhe bojkotit të procesit të referendumit, kishte mungesë të debatit të organizuar publik ndërmjet pjesëmarrësve të fushatës.

Disa bashkëbisedues shprehën pretendime për frikësimin e votuesve, duke përfshirë presionin ndaj nëpunësve shtetërorë dhe mësimdhënësve për të votuar, si dhe për përpjekje të qarta për ta shtypur votimin, ndonëse MVR-së së ODIHR-it nuk iu ofruan dëshmi konkrete për t'i mbështetur këto pretendime (shih poashtu seksionet *Dita e referendumit* dhe *Kundërshtimet dhe ankesat*). Në një Prokurori publike lokale u parashtrua një denoncim në lidhje me shkeljen e pretenduar të Kodit Penal gjatë njëres nga paraqitjet publike të kryeministrit në fushatë.⁵¹

Të gjitha rastet dhe pretendimet për presion dhe frikësim duhet të hetohen plotësisht dhe në mënyrë efektive dhe, ato që janë të bazuara, të ndiqen penalisht nga autoritetet, edhe atë në kohë. Autoritetet gjithashtu duhet të ofrojnë informacione publike për atë çka paraqet aktivitet korruptiv gjatë fushatës së referendumit.

VIII. FINANCIMI I FUSHATËS

Partitë dhe pjesëmarrësit e tjerë mund t'i vetëfinanconin fushatat e tyre nëpërmjet donacioneve private. Edhe pse korniza ligjore nuk parasheh financim publik të referendumit, qeveria i ndau Kuvendit 80

⁴⁷ Më 12 shtator, një grup i themeluesve të partisë publikoi një dokument në mbështetje të referendumit. Kryetari i Kavadarit theksoi se partia duhet t'u bëjë thirrje anëtarëve të saj që të votojnë, ndërsa një këshilltar komunal në Shkup deklaroi se e mbështet referendumin. Një ish-ministër i punëve të jashtme dhe një ish-kryetar i partisë haptazi u angazhuan për bojkotim.

⁴⁸ MVR-ja e ODIHR-it vëzhgoi nëntë tubime bojkotuese në Shkup, Shtip, Strumicë dhe Gjevgjeli dhe një autobus "Bojkotoj" në Manastir, Kumanovë, Mogillë, Novaci, Rankovc dhe Nagoriçan të Vjetër.

⁴⁹ Analizat e Twitter-it që u realizuan nga përmbledhësi i lajmeve Time.mk treguan se kjo me gjasë ishte rezultat i një numri të vogël të shfrytëzuesve të Twitter-it, që i kanë shpërndarë përmbajtjet e njëjta me qëllim që të përforcohet dukshmëria e temës, mirëpo pa arritur deri te audienca e gjerë në mediat sociale.

⁵⁰ Presidenti Ivanov e dënoi mungesën e konsensusit rreth vendimit për të mbajtur referendum dhe e shfrytëzoi rastin e fjalimit të tij në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së më 27 shtator për t'a riafirmuar qëndrimin e tij në favor të bojkotit.

⁵¹ Në tubimin e mbajtur më 12 shtator në Kriva Pallankë, kryeministri si duket [i inkurajoi pronarët e bizneseve](#) t'u paguajnë bonuse të punësuarve për të votuar. LSDM-ja më vonë u përgjigj se "inkurajimi i rrogave më të larta për të gjithë punëtorët është përgjegjësi e çdo kryeministri dhe e qeverisë që ai/ajo e drejton" dhe se "votimi i lirë i qytetarëve është i garantuar". Denoncimi është ende nën hetim.

milionë denarë (rreth 1.3 milionë euro), në rolin e tij si propozues i autorizuar, për t'i përdorur për reklama në media gjatë fushatës së referendumit. Komisioni për koordinim në kuadër të Kuvendit hapi një llogari të veçantë bankare për këtë financim publik dhe i pagoi drejtpërdrejt stacionet televizive dhe të radios për kohën e transmetimit (shih seksionin *Mediat*). VMRO-DPMNE-ja e kritikoi vendimin për të ndarë mjete publike dhe e refuzoi pjesën e saj të mjeteve financiare, duke thënë se përdorimi i këtillë i financimit publik nuk është në interes të qytetarëve.⁵² Si rezultat, mjetet publike u shpenzuan vetëm në emër të fushatës 'Për'. Disa parti të vogla dhe organizata të shoqërisë civile po ashtu e kundërshtuan përdorimin e mjeteve të qeverisë.⁵³

Korniza ligjore për financimin e fushatës së referendumit nuk përmban kufizime për shpenzim dhe ka mungesë të kërkesave të qarta për zbulimin e shpenzimeve, procedurave për revizion dhe sanksioneve. Rregullat e KSHZ-së kërkuan që vetëm Kuvendi si propozues zyrtar të dorëzojë raport financiar për fushatën, edhe atë vetëm për përdorimin e mjeteve publike, në afat prej 30 ditësh pas referendumit.⁵⁴ Nuk ka detyrim ligjor që ky raport t'i nënshtrohet revizionit të ESHR-së.⁵⁵

Për dallim nga zgjedhjet, nga partitë politike dhe palët e tjera të interesuara nuk u kërkuar të japin llogari për donacionet dhe shpenzimet e tyre për fushatën. Nga partitë politike u kërkuar të raportojnë për shpenzimet e tyre vetëm si pjesë e raportimit të tyre financiar vjetor, që duhet të bëhet në vitin 2019, dhe që i nënshtrohet revizionit nga ESHR-ja. Disa bashkëbisedues të MVR-së së ODIHR-it shprehën shqetësime në lidhje me mungesën e informatave për burimet e financimit për aktivitetet e fushatës së referendumit. Mungesa e rregullave për financimin e fushatës e zvogëloi transparencën dhe është në kundërshtim me standardet ndërkombëtare.⁵⁶

Korniza ligjore për financimin e fushatës së referendumit duhet të ndryshohet për ta qartësuar përdorimin e mjeteve publike, si dhe kërkesat për zbulimin e shpenzimeve, revizionin dhe sanksionet. Për ta rritur transparencën, duhet konsideruar mundësia për të kërkuar raporte të përkohshme financiare që do të publikohen para ditës së referendumit.

⁵² 40 për qind e mjeteve financiare të dedikuara për opozitën do të kthehen në buxhetin e qeverisë.

⁵³ Seksioni II.3.4. i [Kodit të praktikave të mira për referendumet](#) thekson se rregullat e përgjithshme për financimin e partive politike dhe fushatave zgjedhore duhet të vlejné edhe për financimin publik edhe për atë privat të referendumeve. Partia politike *Levica* dorëzoi një letër në Entin Shtetëror për Revizion (ESHR) duke kërkuar që të shqyrtohet përputhja e vendimit për ndarjen e mjeteve publike me Ligjin për financimin e partive politike. ESHR-ja e informoi MVR-në e ODIHR-it se do ta shqyrtojë këtë kërkesë gjatë revizionit të saj të ardhshëm vjetor në vitin 2019.

⁵⁴ Raporti, i cili u dorëzua më 29 tetor, tregon se te cilët transmetues janë shpenzuar mjetet, por nuk tregon nëse çdo këst është shpenzuar në emër të ndonjë partie të veçantë parlamentare.

⁵⁵ Në përputhje me rregullat e KSHZ-së, ky raport është dorëzuar në ESHR dhe KSHZ. Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK), i cili gjithashtu ishte pranues i mjeteve sipas rregullave, nuk funksiononte gjatë referendumit, pasi të gjithë anëtarët e tij kishin dhënë dorëheqje. ESHR-ja e informoi MVR-në e ODIHR-it se planifikonte ta shqyronte raportin si pjesë e planit të saj të revizionit për vitin 2019.

⁵⁶ Neni 7.3 i Konventës së KB-ve kundër korrupsionit të vitit 2003 kërkon nga vendet që "të konsiderojnë marrjen e masave të përshtatshme legislative dhe administrative, që janë konsekuente me qëllimet e kësaj Konvente dhe në përputhje me parimet themelore të ligjit vendor të tij, për ta rritur transparencën në financimin e kandidaturave për funksionet e zgjedhura publike dhe, kur është e mundur, financimin e partive politike". Shih po ashtu, paragrafin 159 të [Udhëzimeve të përbashkëta për partitë politike të ODIHR-it/Komisionit të Venedikut të vitit 2010](#) dhe Seksionin I.2.2. të [Kodit të praktikës së mirë për referendumet](#).

IX. MEDIAT

A. AMBIENTI MEDIATIK

Ambienti mediatic përbëhet nga rreth 130 transmetues, duke përfshirë mbi 15 kanale televizive që transmetojnë në gjithë territorin e vendit, 6 gazeta të përditshme, si dhe ueb-faqe të shumta që ofronin përmbajtje me lajme. Televizioni mbetet qartësisht burimi më i rëndësishëm i informimit, e më pas vijnë burimet e internetit. Facebook-u ka pozitë dominuese në mesin e mediave sociale.

Shumica e gazetarëve me të cilët u takua MVR-ja e ODIHR-it theksuan se gjatë viteve të fundit është përmirësuar atmosfera e punës dhe se është zvogëluar presioni politik. Megjithatë, mediat vazhdojnë të kenë vështirësi financiare, veçanërisht në nivel lokal.

Edhe pse qeveria ka përpiluar ndryshime të kornizës ligjore me të cilat synohet të përmirësohet ambienti mediatic, ende nuk është zbatuar asnjë reformë strukturore. Taksa e radiodifuzionit me të cilën më parë financohej transmetuesi publik i radiodifuzionit u hoq në vitin 2017. Sistemi i ri për financimin e transmetuesit publik përbëhet nga kontributi i drejtpërdrejtë prej 0.5 për qind nga buxheti i shtetit, të cilin transmetuesi publik dhe bashkëbiseduesit e tjerë të MVR-së së ODIHR-it e përshkruan si të pamjaftueshëm për t'i financuar aktivitetet e transmetuesit publik.

B. KORNIZA LIGJORE

Në përgjithësi, pjesët kyçe të legjislacionit, duke përfshirë Ligjin për shërbime audio dhe audiovizuale mediatike, Ligjin për Referendum dhe Kodin Zgjedhor, kanë mungesë të detajeve për mbulimin mediatic të referendumeve. Legjislacioni u plotësua me rregulloret dhe udhëzimet e KSHZ-së, të miratuara nga organi rregullator i mediave - Agjencia për Shërbime Audio dhe Audiovizuale Mediatike (ASHAAM).

Të dyja institucionet ofruan udhëzime kontradiktore lidhur me qasjen në reklamat e paguara për palët e interesuara të referendumit.⁵⁷ Udhëzimet e ASHAAM-it përcaktonin që stacionet e radios dhe të televizionit mund të dedikonin maksimum nëntë minuta në orë për reklamat e paguara në lidhje me referendumin për të gjithë pjesëmarrësit e fushatës, të ndara në dy pjesë të barabarta nga katër minuta e gjysmë për të dyja palët - për ata që zhvillojnë fushatë në favor të pyetjes, dhe për ata që zhvillojnë fushatë kundër ose që angazhohen për bojkotim. Përkundrazi, rregullat e KSHZ-së parashihnin se vetëm Kuvendit si propozuesi i autorizuar i referendumit duhej t'i ndahej kohë e dedikuar e transmetimit për fushatën e paguar, ndërsa subjektet e tjera të interesuara për të vendosur klipe të paguara të reklamave mund ta bëjnë këtë si pjesë e 12 minutave në orë të dedikuara për reklama të rregullta komerciale.⁵⁸

Për më tepër, për dallim nga qasja e ASHAAM-it për ta ndarë kohën e paguar të transmetimit në mënyrë të barabartë, komisioni për koordinim i parlamentit mori qëndrimin se koha e transmetimit duhet të ndahet proporcionalisht sipas numrit të deputetëve që formalisht u deklaruan 'Për' dhe 'Kundër' ose 'Bojkoto'. Megjithatë, asnjë deputet nuk e deklaroi qëndrimin e tij, përveç 71 deputetëve (59 përqind) që u deklaruan 'Për'. Shumica e kanaleve televizive të monitoruara nga MVR-ja e ODIHR-it në disa raste i

⁵⁷ ASHAAM-i, organi rregullator i pavarur jofitimprurës, është i obliguar ligjërisht që t'i monitorojë transmetuesit gjatë periudhës së fushatës.

⁵⁸ Kushtet e dyta të përmendura më lartë vlenin për shoqërinë qytetare, grupet ndërkombëtare si p.sh. BE-ja, dhe partitë politike jo-parlamentare.

tejkaluuan afatet kohore për klipet ‘Për’ që ishin caktuar nga ASHAAM-i, veçanërisht në ditët e fundit të periudhës së fushatës.

Legjislacioni kryesor për mbajtjen e referendumeve duhet të ndryshohet për të ofruar parime të përgjithshme për mbulimin mediatik të fushatës së referendumit. Në veçanti, ai duhet ta garantojë barazinë e mundësive për mbështetësit dhe kundërshtarët e propozimit për të cilin votohet, me modalitete për mediat publike dhe ato private, në përputhje me lirinë e shprehjes.

Legjislacioni duhet ta përcaktojë qartë institucionin kryesor që do ta rregullojë mbulimin e mediave transmetuese gjatë fushatës së referendumit.

Sipas kornizës ligjore, mediat publike nuk janë të obliguara të ofrojnë hapësirë për transmetim falas gjatë referendumeve. Shoqata e gazetarëve të Maqedonisë shprehu shqetësime, si publikisht ashtu edhe MVR-së së ODIHR-it, se financimi publik i fushatës së referendumit për reklamim në media do ta përforconte ndikimin tashmë ekzistues të partive politike mbi mediat dhe raportimin e tyre për proceset politike. Me ndryshimet e paradokshme të Kodit Zgjedhor u fut një model i ngjashëm i financimit publik të reklamave të garuesve për fushatat e ardhshme zgjedhore. Me këto ndryshime, KSHZ-ja u autorizua që t’i regjistrojë dhe t’i monitorojë mediat elektronike (portalet në internet). Këto dispozita ende nuk ishin në fuqi gjatë fushatës së referendumit, por zbatueshmëria e tyre në të ardhmen ishte një shqetësim për shumë bashkëbisedues të MVR-së së ODIHR-it.

C. MONITORIMI I MEDIAVE NGA MVR-JA

MVR-ja e ODIHR-it i filloi aktivitetet e saj të monitorimit të mediave më 3 shtator.⁵⁹ Gjatë periudhës së monitorimit, mediat u ofruan qytetarëve informata të bollshme në lidhje me referendumin. Reklamata në lidhje me fushatën u emetuan rregullisht në mediat kombëtare private duke filluar nga 8 shtatori.⁶⁰

Në përgjithësi, mediat ofruan mbulim korrekt. Megjithatë, fakti që nuk kishte fushatë të organizuar ‘Kundër’, në kombinim me fushatën për ‘Bojkot’ që u zhvillua kryesisht në mediat sociale, e ndërlikoi mundësinë e mediave informative që të ofrojnë mbulim të barabartë për të dyja palët. Si rezultat i kësaj, pikëpamjet e shprehura nga fushata ‘Për’ qartazi dominuan në mesin e të gjithë transmetuesve. Raportimet që i lartësonin përfitimet nga integrimi në BE dhe në NATO u prezantuan gjerësisht në media, veçanërisht në edicionet e lajmeve, nëpërmjet mbulimit të aktiviteteve të qeverisë për fushatën dhe vizitave të shpeshta të nivelit të lartë nga zyrtarët e BE-së dhe të NATO-s.

Kronikat e lajmeve që kishin të bëjnë me fushatën ‘Për’ dhe prezantimin e pikëpamjeve të favorshme apo neutrale ndaj BE-së, NATO-s dhe marrëveshjes tejkaluuan 40 përqind në kanalet e monitoruara televizive që transmetuan edicione lajmesh. Informatat në lidhje me qëndrimet ‘Kundër’ ose ‘Bojkot’, duke i përfshirë edhe pikëpamjet kritike për marrëveshjen ose për BE-në dhe NATO-n, përfshinë rreth 10 përqind të hapësirës mediatike të dedikuara për çështjet që kanë të bëjnë me referendumin, në edicionet e

⁵⁹ MVR-ja e ODIHR-it i monitoroi programet që emetohen në periudhën me shikim më të madh (18:00 - 24:00) të emetuara nga kanalet televizive publike RTM1, RTM2 dhe Kanali i Kuvendit dhe kanalet televizive private Alfa, Alsat-M, Kanal 5, Sitel, Telma, dhe TV 24 Vesti. U monitoruan edhe edicionet e lajmeve dhe segmentet e reklamimit të paguar të TV21.

⁶⁰ Mediat transmetuese rajonale dhe lokale poashtu transmetuan klipe të fushatës të financuara nga mjetet publike, por në krahasim me mediat kombëtare, periudha e transmetimit ishte vetëm rreth dy javë.

lajmeve të kanaleve të monitoruar televizive.⁶¹ Të gjitha kanalet i dedikuan një pjesë të rëndësishme të kohës për transmetim informatave për votuesit dhe detajeve të tjera të kontekstit dhe procesit të referendumit.

Pozitivisht, shumica e kanaleve të monitoruara televizive organizuan programe speciale kushtuar kontekstit më të gjerë të referendumit, dhe prezantuan pikëpamje të ndryshme në lidhje me marrëveshjen.⁶²

Në mungesë të deputetëve që do të angazhoheshin për qëndrimet ‘Kundër’ ose ‘Bojkot’, në media u transmetuan vetëm reklamat e financuara me mjete publike që e promovonin fushatën ‘Për’. Megjithatë, në fund të fushatës, partia jashtëparlamentare “Zëri për Maqedoninë” zhvilloi një fushatë të kufizuar të paguar për ta promovuar bojkotimin.

Përveç fushatës zyrtare të referendumit, u transmetuan edhe klipe që e promovonin BE-në dhe dobitë e saj, si pjesë e fushatës zyrtare për informim të BE-së (“BE-ja për ty”). Organizatat e shoqërisë civile po ashtu e promovuan anëtarësimin në BE dhe në NATO në reklamat e paguara televizive.

D. MBIKËQYRJA E MEDIAVE

ASHAAM-i i monitoroi mediat transmetuese kombëtare duke filluar nga 10 shtatori dhe lëshoi dy raporte, para dhe pas ditës së referendumit.⁶³ Më 14 shtator, kjo agjenci lëshoi një deklaratë ku i paralajmëroi transmetuesit se koha e ndarë për reklamat ‘Për’ po i tejkalonte kufizimet e lejuara dhe ua tërhoqi vërejtjen që ta respektojnë kornizën ligjore dhe udhëzimin e ASHAAM-it.

Pas fazës së parë të periudhës së monitorimit, ASHAAM-i inicioi procedura kundërvajtëse kundër dy transmetuesve për mosrespektimin e dispozitës që ka të bëjë me reklamimin e paguar politik, e po ashtu edhe për shkeljen e ndalimit për publikimin e anketave zgjedhore gjatë pesë ditëve para ditës së referendumit.⁶⁴ Në periudhën e dytë të monitorimit, ASHAAM-i identifikoi disa transmetues kombëtarë të cilët i tejkaluan kufizimet e lejuara për reklamat ‘Për’, por duke pasur parasysh mungesën e dispozitave të qarta ligjore për atë se çka nënkupton mbulimi i barabartë i fushatave të referendumit, organi rregullator i mediave nuk inicioi asnjë procedurë kundërvajtëse për këtë aspekt.⁶⁵

⁶¹ Nga të gjitha kanalet e monitoruara televizive, *TV Alfa* ndau pjesën më të madhe të kohës së transmetimit në edicionet e lajmeve për informatat që e kundërshtonin referendumin - rreth 17 përqind. Ky televizion po ashtu ndau një pjesë të konsiderueshme të kohës për transmetim për fushatën ‘Për’, mirëpo mbulimi i tij dhe komentet e gazetarëve të tij ishin në përgjithësi kritike. *TV Alfa* po ashtu ishte kanali i vetëm që e prezantoi qeverinë aktuale në ditë negative. Portretizimi i qeverisë dhe i aktorëve politikë nga kanalet tjera televizive ishte kryesisht neutral.

⁶² Debate në lidhje me referendumin kishte në këto kanale të monitoruara televizive: *RTM1, RTM2, Alfa, Alsat-M, Kanal 5, Telma, TV 24 Vesti* dhe *TV 21*. Një mbulim krejtësisht ndryshe të çështjeve në lidhje me referendumin u ofrua nga emisioni politik “360 shkallë” që u transmetua në televizionin *Alsat-M*. Përfshirja e mediave rajonale ose lokale në fushatën e referendumit ishte më pak aktive, por disa media rajonale ose lokale u përpoqën të organizonin debate ose programe të tjera kushtuar çështjeve të referendumit dhe kontekstit të tij.

⁶³ Raporti i parë ASHAAM-it që e përfshin periudhën nga 10 deri më 18 shtator 2018 u publikua më 25 shtator 2018. Raporti i dytë për periudhën nga 19 deri më 27 shtator 2018 u publikua më 4 tetor 2018.

⁶⁴ ASHAAM-i konkludoi se *ITV* nuk i kishte respektuar kufizimet e lejuara kohore për transmetimin e mesazheve reklamuese ‘Për’ referendumin, ndërsa në një rast tjetër, kishte publikuar një anketë brenda pesë ditëve nga dita e referendumit, duke e shkelur ndalimin për publikimin e tillë në këtë periudhë. “*Sonce TV*” e shkeli ndalesën për transmetimin e reklamave të paguara në kuadër të edicioneve të lajmeve.

⁶⁵ Sipas raportit të dytë të monitorimit të ASHAAM-it, në periudhën prej 21 deri më 27 shtator kanalet e mëposhtme televizive e tejkaluan kohën për reklamim dhe e shkelën nenin 28 të Udhëzimeve të ASHAAM-it: *ITV, 24 Vesti, TV 21, TV Sitel, TV Telma, TV Kanal 5* dhe *TV Alsat-M*.

Mediat onlajn janë, pas televizionit, burimi i dytë më i rëndësishëm i informimit politik në vend. Mbështetësi kryesor i bojkotit, që vepronte nën emrin “*Bojkotoj*”, kishte një prezencë të fortë në mediat sociale. Materialet e mediave sociale me përmbajtje nxitëse ose provokative të identifikuar nga MVR-ja e ODIHR-it shpërndareshin shpesh nga llogaritë e “*Bojkotoj*” në Tëitter, të cilat u krijuan në muajt para referendumit dhe u përqendruan vetëm në çështjet që kishin të bëjnë me referendumin. MVR-ja e ODIHR-it vërejti se gjatë tre javëve para 30 shtatorit, “*Bojkotoj*” mbeti tema më e diskutuar midis përdoruesve të Twitter-it në vend.⁶⁶

X. VËZHGESIT QYTETARË DHE NDËRKOMBËTARË

Kodi Zgjedhor dhe rregullat e KSHZ-së parashohin vëzhgim të referendumit nga vëzhguesit ndërkombëtarë dhe ata qytetarë. Sipas kornizës ligjore, vetëm Kuvendit si propozues i autorizuar i referendumit iu lejua të emërojë një përfaqësues të posaçëm për ta vëzhguar punën e administratës së referendumit në çdo komision dhe në çdo vendvotim. Përndryshe, vëzhguesit e partive politike nuk u lejuan. Përkundër aplikimit nga VMRO-DPMNE-ja për të emëruar vëzhgues, Kuvendi nuk emëroi asnjë të tillë.⁶⁷

Disa parti politike iu ankuan MVR-së së ODIHR-it se rregullat për vëzhgimin e referendumit ua mohuan të drejtën për të vëzhguar. Mospërfshirja e vëzhguesve partiakë në vendvotime, në kombinim me mungesën e anëtarëve të KZ-ve të emëruar nga partitë, e zvogëloi transparencën e përgjithshme të procesit dhe i sfidoi angazhimet e OSBE-së dhe praktikën e mirë ndërkombëtare.⁶⁸

Në përputhje me angazhimet e OSBE-së dhe për të siguruar transparencë për të gjitha palët e interesuara, korniza ligjore duhet të parashohë vëzhgim partiak të të gjitha fazave të procesit të referendumit.

Në një proces inkluziv, KSHZ-ja akreditoi rreth 493 vëzhgues ndërkombëtarë dhe 11.927 vëzhgues qytetarë. Dy organizata qytetare vëzhguese me përvojë shpërndanë vëzhgues për fushatën dhe ditën e votimit.⁶⁹ Në ditën e referendumit, MOST-i shpërndau 1.902 vëzhgues, duke përfshirë edhe disa ekipe të lëvizshme, dhe realizoi një aktivitet paralel të nxjerrjes së rezultateve. CIVIL - Qendra për Liri shpërndau 30 vëzhgues afatgjatë dhe gjithsej 307 vëzhgues të akredituar në ditën e referendumit. Dy organizata të tjera, Platforma e Maqedonisë Kundër Varfërisë (PMKV) me 3.736 vëzhgues dhe Agjencia për Politika

⁶⁶ Sa i përket mediave sociale, analizat e Twitter-it që u realizuan nga përmbledhësi i lajmeve Time.mk treguan se kjo me gjasë ishte rezultat i një grupi të shfrytëzuesve të Twitter-it, që i kanë shpërndarë me shpejtësi përmbajtjet e njëjta (të përgatitura nga një numër i vogël shfrytëzuesish) me qëllim që të përforcohet dukshmëria e temës, mirëpo pa arritur deri te audiencia e gjerë në mediat sociale.

⁶⁷ Në një vendim të datës 24 shtator, komisioni për koordinim i Kuvendit njoftoi se nuk do të emërojë përfaqësues në vendvotime për shkak të besimit të tij të plotë në procesin dhe për shkak të prezencës së vëzhguesve qytetarë dhe atyre ndërkombëtarë.

⁶⁸ Në paragrafin 8 të [Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990](#), vendet pjesëmarrëse pranuan se “prania e vëzhguesve, edhe të huaj edhe të vendit, mund ta përmirësojë procesin zgjedhor në vendet në të cilat mbahen zgjedhjet” dhe u përkushtuan të ftojë vëzhgues “nga cilat do qoftë institucione private të përshtatshme dhe organizata të cilat mund të dëshirojnë t’i vëzhgojnë procedurat e zgjedhjeve të tyre kombëtare”. Sipas [Seksionit I.3.2.a.x. të Kodit të praktikës së mirë për referendumet](#), “vendvotimet duhet të përfshijnë përfaqësues të disa partive, dhe praninë e vëzhguesve të emëruar prej tyre ose nga grupet e tjera që kanë marrë qëndrim në lidhje me çështjen për të cilën votohet...”.

⁶⁹ Vëzhgues qytetarë u shpërndanë nga gjithsej 10 organizata të shoqërisë civile.

dhe Iniciativa Qytetare (IDULSJ) me 5.574 vëzhgues, i akredituan shumicën e vëzhguesve të tyre në ditët e fundit të periudhës së akreditimit, duke futur shumë shtesa në listën e vëzhguesve të akredituar pas afatit zyrtar, gjë që ndikoi negativisht në lëshimin e akreditimeve individuale për vëzhguesit formalë. KSHZ-ja pranoi 39 kërkesa shtesë për akreditim në seancën e saj zyrtare më 25 shtator, pa i specifikuar emrat e shoqatave dhe numrin e vëzhguesve, duke mos e njoftuar elektoratin sipas rregullit dhe në kohë.⁷⁰

Për ta rritur llogaridhënien e vëzhguesve të zgjedhjeve dhe për ta inkurajuar transparencën, distinktivët e akreditimit duhet ta identifikojnë vëzhguesin, si dhe organizatën që e përfaqëson.

XI. KUNDËRSHTIMET DHE ANKESAT

Ligji për Referendum u jep të gjithë votuesve të drejtën për të parashtruar kundërshtime në lidhje me parregullsitë në procedurat e ditës së votimit dhe nxjerrjen e rezultateve në KSHZ brenda 24 orëve.⁷¹ KSHZ-ja miratoi një rregullore për zgjidhjen e kontesteve në lidhje me referendumin gjë që e ngushtoi bazën ligjore për qytetarët që të parashtrorjnë kundërshtime. Sipas kësaj rregulloreje, votuesit mund të parashtrorjnë kundërshtim vetëm nëse kanë qenë në listën e votuesve dhe kanë qenë të pranishëm në vendvotim, dhe nëse kanë kërkuar që parregullsitë të shënohet në procesverbalin e KZ-së ose KZK-së përkatëse. KSHZ-ja po ashtu e futi të drejtën e propozuesit të autorizuar për të parashtruar kundërshtime, duke përfshirë edhe kundërshtimin e rezultateve, por nuk u parashtrua asnjë kundërshtim i tillë, pasi Kuvendi nuk caktoi asnjë përfaqësues në vendvotime. Baza ligjore që KSHZ-ja t'i fusë këto ndryshime ishte e paqartë.

KSHZ-ja pranoi 12 kundërshtime formale para ditës së referendumit, 10 në lidhje me refuzimin e kërkesave për votim në shtëpi, ndërsa dy në lidhje me përjashtimin e votuesit nga lista e votuesve.⁷² Kundërshtimet u zgjidhën në seanca të mbyllura dhe nuk u vendosën në sistemin elektronik për menaxhim të kundërshtimeve, që është në kundërshtim me kërkesat ligjore për transparencë.⁷³

Në ditën e referendumit, KSHZ-ja pranoi 40 kundërshtime të parashtruara nga qytetarë që nuk mundën t'i gjejnë emrat e tyre në listat e votuesve.⁷⁴ KSHZ-ja i hodhi poshtë të gjitha kundërshtimet duke thënë se afati i fundit për t'u përfshirë në listat e votuesve kishte kaluar.⁷⁵ Pas ditës së referendumit, KSHZ-ja pranoi gjashtë kundërshtime të tjera, pesë prej të cilave u hodhën poshtë për shkak të mospërmbyshjes së kërkesave të pranueshmërisë së KSHZ-së.⁷⁶ Megjithatë një kundërshtim i parashtruar nga një vëzhgues vendor u hodh poshtë për shkak të mungesës së bazës ligjore, provat që i ishin bashkangjitur këtij kundërshtimi e shtynë KSHZ-në që të veprojë sipas detyrës zyrtare dhe kjo çoi në anulimin e rezultateve

⁷⁰ Rregullat e KSHZ-së kërkuar që në distinktiv të shënohet vetëm emri i vëzhguesit, si dhe numri i vendvotimeve ku ai/ajo do të vëzhgojë në ditën e votimit. MVR-ja e ODIHR-it pa vëzhgues me distinktive të shkruara me dorë ose të përbashkëta.

⁷¹ KZK-të nuk kanë kompetencë mbi kundërshtimet që kanë të bëjnë me referendumin.

⁷² KSHZ-ja pranoi tetë kundërshtime për votimin në shtëpi, ndërsa dy ankesa të tilla u refuzuan për shkak të mungesës së dokumenteve mbështetëse. Dy kundërshtime në lidhje me përjashtimin nga lista e votuesve u refuzuan pasi kishte kaluar afati për regjistrimin e zgjedhësve.

⁷³ Kodi Zgjedhor përcakton se puna e organeve për menaxhimin e zgjedhjeve është publike. Pastaj, ai e obligon KSHZ-në që të krijojë një sistem elektronik për menaxhimin e kundërshtimeve.

⁷⁴ Ombudsmani pranoi kundërshtime të ngjashme nëpërmjet linjës telefonike falas për denoncimin e parregullsive.

⁷⁵ Ligji nuk lejon shtimin e votuesve në listat zgjedhore pas periudhës së këqyrjes publike.

⁷⁶ Katër kundërshtime u parashtruan nga kryetari i organizatës Kongresi Botëror Maqedonas, i cili nuk ishte përfshirë në listën e votuesve në vendvotimet ku ndodhën shkeljet e pretenduara, dhe rrjedhimisht nuk kishte bazë ligjore për t'i parashtruar kundërshtimet.

të votimit në një vendvotim.⁷⁷ Një hap pozitiv, për dallim nga kundërshtimet e një dite para referendumit, ishte se vendimet e KSHZ-së për kundërshtimet në ditën e referendumit u shqyrtuan në mbledhje publike dhe u vendosën në sistemin elektronik për menaxhimin e kundërshtimeve, që kontribuoi për transparencën e procesit.

Siç kërkohet me ligj, Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve duhet t'i shqyrtojë kundërshtimet, duke i përfshirë edhe kundërshtimet e një dite para referendumit, në seanca publike dhe t'i publikojë të gjitha vendimet përmes sistemit elektronik për menaxhim të kundërshtimeve.

Sipas Ligjit për Referendum, për vendimet e KSHZ-së në lidhje me procedurat në ditën e votimit dhe rezultatet mund të parashtrahet ankesë në Gjykatën Supreme në afat prej 48 orësh. Ky mekanizëm dallon nga Kodi Zgjedhor, sipas të cilit Gjykata Administrative është instanca më e lartë për zgjidhjen e kontesteve zgjedhore.⁷⁸ Gjykata Supreme, për shkak të parashtrësive të vonuara, hodhi poshtë dy ankesa në lidhje me parregullsi në ditën e referendumit.

Rregullat e KSHZ-së për referendumin ia transferuan kompetencën për shqyrtimin e ankesave Gjykatës Supreme, pa asnjë bazë ligjore.⁷⁹ Rrjedhimisht, Gjykata Supreme e hodhi poshtë një ankesë nga një qytetar në lidhje me regjistrimin e votuesve, duke përmendur mungesën e kompetencës së saj. Megjithatë, KSHZ-ja vazhdoi të lëshojë vendime për votuesit, në të cilat përmendej Gjykata Supreme si instancë për ankesë, gjë që e komprometoi të drejtën e tyre për mjet efektiv ligjor.

Përveç kësaj, në Prokurorinë Publike u parashtruan disa kundërshtime, duke përfshirë kontestimin e ligjshmërisë së disa vendimeve të KSHZ-së dhe shkeljen e pretenduar të dispozitave të Kodit Penal në fushatën publike të kryeministrit.⁸⁰ Asnjëri prej këtyre kundërshtimeve nuk rezultoi me ndjekje penale.

Gjykata Kushtetuese pranoi tre iniciativa që e kontestuan vendimin e Kuvendit për ta mbajtur referendumin, duke e vënë në pikëpyetje, në mes tjerash, formulimin dhe natyrën e ndërlikuar të pyetjes së referendumit, natyrën konsultative të referendumit, dhe mungesën e sqarimit të ndryshimeve kushtetuese që janë paraparë në marrëveshje.⁸¹ Të tre iniciativat u hodhën poshtë me shumicë votash. Gjatë dëgjimit publik, gjykata debatoi për dobësitë në formalitetet e vendimit për të mbajtur referendum dhe në formulimin e pyetjes, mirëpo vendosi se ato nuk janë kundërkushtetuese.⁸² Në vendimin me shkrim u theksua se edhe pse Kushtetuta kërkon referendum që është ligjërisht i detyrueshëm për t'iu bashkuar në ndonjë lidhje ose aleance ndërkombëtare, referendumi aktual konsultativ nuk u shpall për

⁷⁷ Një vëzhgues i paidentifikuar vuri në dukje një mospërputhje ndërmjet numrit të votuesve që kanë dalë në referendum në protokollin përfundimtar të KZ-së që ai/ajo e ka pranuar dhe numrit në ueb-faqen e KSHZ-së si dëshmi për ndryshimet e paautorizuara të protokollit të rezultateve.

⁷⁸ Ministri i Drejtësisë e informoi MVR-në e ODIHR-it se kjo mundësi për ankim është rezultat i Ligjit të vjetruar për Referendum, i cili i ka paraprirë krijimit të Gjykatës Administrative.

⁷⁹ Sipas Kodit Zgjedhor, ankesat kundër vendimeve të KSHZ-së në lidhje me regjistrimin e votuesve shqyrtohen nga Gjykata Administrative. Ligji për Referendumin nuk përcakton kompetencë të Gjykatës Supreme për kundërshtimet në lidhje me regjistrimin e votuesve. Seksioni II.3.3.c. i [Kodit të praktikës së mirë për referendumet](#) rekomandon se “procedura e ankimit dhe, në veçanti, kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve të ndryshme, duhet të rregullohen qartë me ligj, në mënyrë që të shmangen konfliktet e juridiksionit (pavarësisht nëse janë të karakterit pozitiv apo negativ)”.

⁸⁰ Sipas kundërshtimit, pretendohet se të gjithë anëtarët e KSHZ-së e kanë shkelur nenin 353 (keqpërdorim i detyrës zyrtare) dhe nenin 392 (autokraci) të Kodit Penal duke i miratuar rregullat jashtë diapazonit të kornizës ekzistuese ligjore.

⁸¹ Kundërshtimet u parashtruan nga *Levica*, Kongresi Botëror Maqedonas dhe një person privat. Dy kërkesa u parashtruan në Gjykatën Kushtetuese pas dëgjimit publik nga gjykata më 19 shtator.

⁸² Sipas deklaratave të gjyqtarëve gjatë seancës së hapur, shtatë nga nëntë gjyqtarë e mbështetën kushtetutshmërinë e referendumit. Diskutimi dhe votimi nuk ishin publik.

këtë çështje. Përveç kësaj, në vendim thuhej se pyetja e referendumit ishte e qartë për shkak se çështjet që i përmbante ajo ishin të ndërlikura.

XII. DITA E REFERENDUMIT

A. VOTIMI, NUMËRIMI DHE NXJERRJA E REZULTATEVE

Votimi i hershëm dhe dita e referendumit kaluan në mënyrë të rregullt dhe pa parregullsi të mëdha. Procesi i ditës së referendumit ishte i organizuar mirë dhe u administrua në mënyrë profesionale. Procedurat e votimit, numërimit dhe nxjerrjes së rezultateve në përgjithësi u respektuan mirë dhe u siguria transparenca e procesit.

Vëzhguesit qytetarë ishin të pranishëm në 90 për qind të vendvotimeve dhe të qendrave për nxjerrjen e rezultateve që u vëzhguan. Megjithatë, vëzhguesit e MNVR-së vërejtën një konfuzion në masë të gjerë në lidhje me identitetin e organizatave që u përfaqësuan nga disa vëzhgues qytetarë. Në 10 për qind të vendvotimeve të vëzhguara, vëzhguesit qytetarë nuk mund ta identifikonin qoftë organizatën e tyre apo t'i përshkruajnë detyrat e tyre si vëzhgues. Megjithëse KSHZ-ja nuk akreditoi asnjë përfaqësues të autorizuar, në disa raste, vëzhguesit u prezantuan si përfaqësues të autorizuar të Kuvendit, të partive politike ose të KZK-ve. Vëzhguesit e MNVR-së konstatuan se një numër i madh i këtyre vëzhguesve qytetarë ishin të akredituar për PMKVN-në ose IDULSJ-në.⁸³

Votimi i hershëm u realizua më 29 shtator për votuesit në shtëpi dhe për ata që janë në burg shtëpiak ose në burg. MVR-ja e ODIHR-it e vëzhgoi votimin e hershëm në të gjitha 13 burgjet në vend dhe në 69 KZ.⁸⁴ Në përgjithësi, procesi u vlerësua si i mirë ose shumë i mirë në 92 për qind të vëzhgimeve. Megjithatë, në dy burgje dhe në pesë KZ procesi u vlerësua negativisht. Fshtësia e votës u komprometua në pesë raste, kutia e votimit nuk ishte mbyllur siç duhet në pesë raste, dhe procedurat nuk u ndoqën ose nuk u kuptuan nga votuesit në pesë raste. Vëzhguesit qytetarë ishin të pranishëm në 45 për qind të vëzhgimeve të votimit të hershëm.

Në ditën e referendumit, MNVR-ja e vlerësoi hapjen si të mirë ose shumë të mirë në 72 nga 75 vëzhgimet. Edhe pse u respektuan shumica e procedurave, në 15 raste vëzhguesit vërejtën se kutia e votimit nuk iu tregua vëzhguesve para se të mbyllet dhe në 13 raste protokollin për hapjen e vendvotimit nuk u plotësua para se të hapet vendvotimi, siç është e paraparë.

Vëzhguesit e MNVR-së kishin mundësi ta vëzhgojnë procesin e votimit pa kufizime, dhe vlerësimi i tyre ishte pozitiv në 98 për qind të rasteve. Procedurat e votimit u respektuan mirë dhe procesi ishte transparent. Nuk kishte parregullsi të mëdha. Në 13 për qind të vëzhgimeve, disa votuesve nuk iu lejua e drejta e votës pasi që nuk ishin në listën e votuesve ose nuk posedonin dokument adekuat të identifikimit.

Prokuroria publike pranoi 40 denoncime për shkelje të pretenduara të të drejtave të votës në ditën e referendumit, duke përfshirë shkeljet e rendit publik, përpjekjet për t'i fotografuar fletëvotimet dhe votuesit brenda dhe jashtë vendvotimeve, si dhe shkelje të fshtësisë së votës. Gjithashtu, edhe MPB-ja

⁸³ Shumë vëzhgues të këtyre grupeve u prezantuan si vëzhgues partiakë qoftë të LSDM-së apo të VMRO-DPMNE-së. Sipas [Deklaratës së Parimeve për Vëzhgimin Ndërkombëtar të Zgjedhjeve të vitit 2005](#), vëzhguesit qytetarë duhet të jenë të paanshëm dhe neutralë.

⁸⁴ Gjithsej kishte 2.041 votues të regjistruar për votim në shtëpi dhe 1.558 për votim në burg.

pranoi disa denoncime për frikësimin e votuesve në ditën e referendumit, në formë të video-incizimeve ose të fotografive të votuesve në vendvotime, si përpjekje e qartë për ta shtypur ose për ta nxitur pjesëmarrjen në votim.⁸⁵

Para referendumit, KSHZ-ja lëshoi udhëzime duke kërkuar që të gjitha vendvotimet të vendosen në katin përdhes të ndërtesave komunale. Edhe pse në më shumë se gjysmën e vendvotimeve të vëzhguara personat me aftësi të kufizuara nuk mund të hynin në mënyrë të pavarur, organizimi i hapësirës në brendi të vendvotimeve në përgjithësi ishte i përshtatshëm për personat me aftësi të kufizuara fizike. Për ta lehtësuar votimin e personave me shikim të dëmtuar, në 94 për qind të vendvotimeve të vëzhguara kishte fletëvotim me alfabet të Brejtit.

MNVR-ja i vëzhgoi procedurat e numërimit në 80 vendvotime. Edhe pse vlerësimi në përgjithësi ishte pozitiv, vëzhguesit e MNVR-së vërejtën se jo të gjitha procedurat u kompletuan në tërësi ose sipas renditjes së paraparë. Për shembull, krahasimi i numrit të nënshkrimeve në listën e votuesve me numrin e fletëvotimeve të pashfrytëzuara nuk u bë para hapjes së kutisë së votimit në 31 raste. Persona të paautorizuar, kryesisht vëzhgues qytetarë, morën pjesë gjatë numërimit në 10 raste. Në 47 vendvotime të vëzhguara, disa fletëvotime u shpallën të pavlefshme për shkak se nuk ishin shënuar me shenjën e rrethit, edhe pse qëllimi i votuesit ishte i qartë. Në 15 vendvotime të vëzhguara KZ-të nuk i vendosën publikisht protokollet e rezultateve.

Vlerësimi i përgjithshëm i procesit të nxjerrjes së rezultateve në të gjitha 68 KZK-të e vëzhguara ishte pozitiv, me ç'rast procedurat në përgjithësi u respektuan në mënyrë transparente. Në 22 raste kryetari i KZ-së ishte i shoqëruar nga një vëzhgues, që u prezantua si përfaqësues i partisë, gjatë transferimit të materialeve zgjedhore në KZK. MVR-ja e ODIHR-it vërejtë procedura jokonsekuente për korrigjimin e protokolleve të rezultateve, me ç'rast disa KZK i hapnin kutitë e votimit dhe i rinumëronin fletëvotimet, ndërsa disa të tjera i korrigjonin protokollet duke u bazuar vetëm në harmonizimin e rezultateve.

B. SHPALLJA E REZULTATEVE DHE ZHVILLIMET PAS REFERENDUMIT

KSHZ-ja dha informacione për daljen e votuesve në referendum gjashtë herë gjatë ditës së referendumit dhe i shpalli rezultatet preliminare më 1 tetor. Pas skadimit të afatit për kundërshtime, më 3 tetor KSHZ-ja i raportoi Kuvendit se “në bazë të rezultateve përfundimtare të votimit në referendumin e vitit 2018, Vendimi nuk është miratuar sepse më shumë se gjysma e numrit të përgjithshëm të qytetarëve të regjistruar në listat e votuesve nuk kanë votuar”. KSHZ-ja konstatoi se nga 1.806.336 zgjedhës të regjistruar, 666.344 zgjedhës votuan, që përbën 36.89 për qind të elektoratit.⁸⁶ Nga këta votues, 609.427 (91,5 për qind) votuan ‘Për’, ndërsa 37.687 (5.7 për qind) votuan ‘Kundër’. KSHZ-ja konstatoi se kishte 19.221 fletëvotime të pavlefshme, të cilat përbënin 2.9 për qind të fletëvotimeve.⁸⁷

Rezultatet përfundimtare përfshijnë një mospërputhje të konsiderueshme midis votave ‘Për’ dhe atyre ‘Kundër’. Disa rezultate në nivel të KZ-ve tregojnë se fshehtësia e votës mund të ishte rrezikuar për një numër të konsiderueshëm të votuesve, nëse votuesit janë vërejtur duke shkuar në vendvotime në ditën e referendumit. Në kontekst të përpjekjeve të përhapura gjerësisht për bojkotim, çdo votues mund të ketë ndjerë se thjesht hedhja e votës mund të konsiderohet si një veprim partiak. Me rëndësi për t’u theksuar

⁸⁵ MVR-ja e ODIHR-it nuk u informua për asnjë ndjekje penale në këto raste.

⁸⁶ Në këto numra është marrë parasysh anulimi i votimit në një vendvotim në Kumanovë.

⁸⁷ Fletëvotimet e pavlefshme u përfshinë në llogaritjen e pjesëmarrjes së votuesve në referendum.

është se në 301 KZ, 100 për qind e fletëvotimeve të vlefshme përmbanin votë ‘Për’.⁸⁸

Pas shpalljes së rezultateve të referendumit, edhe fushata ‘Për’ edhe ajo për bojkotim, si dhe opozita VMRO-DPMNE, i interpretuan këto rezultate si mbështetje nga votuesit për qëndrimet e tyre përkatëse. Kryeministri i bëri thirrje Kuvendit ta konfirmojë mbështetjen e votuesve për integrimin në BE dhe NATO, ndërsa opozita theksoi se pjesëmarrja e ulët në referendum paraqiste refuzim të marrëveshjes me Greqinë dhe të politikave të tjera të qeverisë nga votuesit.⁸⁹

Më 19 tetor, Kuvendi e arriti shumicën e nevojshme prej dy të tretave për ta filluar procesin e ndryshimit të Kushtetutës, siç parashihet me marrëveshjen, dhe më 3 dhjetor, me shumicë të thjeshtë i miratoi tekstin fillestar të propozim-amendamenteve kushtetuese. Më 11 janar 2019, me shumicë votash prej dy të tretave u miratuan amendamentet kushtetuese. Amendamentet do të hyjnë në fuqi pas ratifikimit të marrëveshjes nga parlamenti i Greqisë.

XIII. REKOMANDIMET

Këto rekomandime janë ofruar me qëllim që të përmirësohet edhe më shumë zhvillimi i zgjedhjeve në vend dhe që të mbështeten përpjekjet për t’i sjellë ato në përputhje të plotë me angazhimet e OSBE-së dhe detyrimet dhe standardet e tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike. Këto rekomandime duhen lexuar së bashku me rekomandimet e mëparshme të ODIHR-it, të cilat ende nuk janë trajtuar. ODIHR-i është i gatshëm që t’u ndihmojë autoriteteve për ta përmirësuar më tej procesin zgjedhor dhe për t’i trajtuar rekomandimet që gjenden në këtë raport dhe në raportet e mëparshme.⁹⁰

A. REKOMANDIMET PRIORITARE

1. Korniza ligjore për referendimet duhet të rishikohet dhe të harmonizohet me Kodin Zgjedhor. Në veçanti, Ligji për Referendumin duhet të ndryshohet për të përfshirë dispozita mbi fushatën dhe financimin e fushatës, që do të jenë specifike për referendimet.
2. Krijimi i regjistrit të përhershëm kombëtar të adresave duhet të jetë prioritet, me ç’rast harmonizimi i të dhënave të vendbanimit duhet të jetë i definuar qartë.
3. Legjislacioni duhet të harmonizohet me qëllimet e KDPAK-së, duke i hequr të gjitha kufizimet e të drejtës së votës në bazë të aftësisë së kufizuar mendore ose intelektuale.
4. Korniza ligjore për financimin e fushatës së referendumit duhet të ndryshohet për ta qartësuar

⁸⁸ Edhe 280 KZ të tjera raportuan se ishte hedhur vetëm një votë e vlefshme ‘Kundër’.

⁸⁹ Kryetari i shtetit, në fjalimin e tij vjetor më 28 dhjetor, e përdori pjesëmarrjen e ulët për ta barazuar mosdaljen në votim me kundërshtimin ndaj çështjes së referendumit.

⁹⁰ Sipas paragrafit 25 të [Dokumentit të Stambollit të OSBE-së të vitit 1999](#), vendet pjesëmarrëse të OSBE-së u angazhuan “t’i ndjekin menjëherë vlerësimet dhe rekomandimet e ODIHR-it për zgjedhjet”. Ndjekja e rekomandimeve të mëparshme nga MVR-ja e ODIHR-it është vlerësuar si më poshtë: nga raporti përfundimtar për zgjedhjet lokale të vitit 2017, rekomandimet 3, 9 dhe 13 kryesisht janë zbatuar, ndërsa rekomandimet 1, 12, 16, 26, 31 dhe 32 janë zbatuar pjesërisht. Nga raporti përfundimtar për zgjedhjet parlamentare të vitit 2016, rekomandimet 11, 15 dhe 21 janë zbatuar plotësisht, rekomandimi 2 është zbatuar kryesisht, ndërsa rekomandimet 1, 22 dhe 29 janë zbatuar pjesërisht. Nga raporti përfundimtar për zgjedhjet presidenciale të vitit 2014, rekomandimi 17 është zbatuar plotësisht, rekomandimet 19, 20, 21 dhe 22 janë zbatuar kryesisht dhe rekomandimet 4, 9, 10, 11 dhe 25 janë zbatuar pjesërisht.

përdorimin e mjeteve publike, si dhe kërkesat për zbulimin e shpenzimeve, revizionin dhe sanksionet. Për ta rritur transparencën, duhet konsideruar mundësia për të kërkuar raporte të përkohshme financiare që do të publikohen para ditës së referendumit.

5. Legjislacioni kryesor për mbajtjen e referendumeve duhet të ndryshohet për të ofruar parime të përgjithshme për mbulimin mediatik të fushatës së referendumit. Në veçanti, ai duhet ta garantojë barazinë e mundësive për mbështetësit dhe kundërshtarët e propozimit për të cilin votohet, me modalitete për mediat publike dhe ato private, në përputhje me lirinë e shprehjes.
6. Siç kërkohet me ligj, KSHZ-ja duhet t'i shqyrtojë kundërshtimet, duke i përfshirë edhe kundërshtimet e një dite para referendumit, në seanca publike dhe t'i publikojë vendimet përmes sistemit elektronik për menaxhim të kundërshtimeve.

B. REKOMANDIME TË TJERA

Korniza ligjore

7. Duhet konsideruar mundësia për ta autorizuar një organ të paanshëm që të rishikojë në kohë çdo pyetjeje të propozuar për referendum, për të siguruar qartësi dhe ligjshmëri.
8. Zbatimi i kriterit të kufirit të pjesëmarrjes së zgjedhësve për referendume konsultative duhet të qartësohet në ligj.

Administrimi i referendumit

9. Kuvendi duhet të miratojë dispozita për Komision të përhershëm Shtetëror të Zgjedhjeve, për të siguruar stabilitet dhe qëndrueshmëri në administrimin e proceseve zgjedhore.
10. Për ta rritur besimin e publikut në punën e KSHZ-së dhe në përputhje me ligjin, KSHZ-ja duhet të sigurojë që të gjitha informatat në lidhje me zgjedhjet që janë me interes publik, duke i përfshirë vendimet dhe procedurat e prokurimit, do të bëhen publike në kohë.
11. Rregullat e KSHZ-së për procedurat e ditës së votimit, duke i përfshirë edhe ato për interpretimin e qëllimit të votuesit, duhet të jenë në përputhje me legjislacionin dhe duhet të miratohen para finalizimit të mjeteve për trajnim. Trajnimi për anëtarët e KZ-ve mund të përqendrohet më shumë në numërimin e votave, me hollësi të mëtejshme për protokollet e rezultateve dhe procedurat e harmonizimit të rezultateve.

Regjistrimi i votuesve

12. Ndarja e detyrave dhe përgjegjësive për mirëmbajtjen e regjistrimit të votuesve duhet të qartësohet dhe të zbatohet, dhe afatet për përditësimet duhet të rishikohen, për të siguruar inkluzivitet dhe saktësi.

Fushata e referendumit

13. Korniza ligjore për zhvillimin e fushatave të referendumit duhet të ndryshohet për të përfshirë rregulla të qarta për zhvillim të fushatës, duke përfshirë edhe pjesëmarrjen e funksionarëve publikë.
14. Të gjitha rastet dhe pretendimet për presion dhe frikësim duhet të hetohen plotësisht dhe në mënyrë efektive dhe, ato që janë të bazuara, të ndiqen penalisht nga autoritetet, edhe atë në kohë. Autoritetet gjithashtu duhet të ofrojnë informacione publike për atë çka paraqet aktivitet korruptiv gjatë fushatës së referendumit.

Mediat

15. Legjislacioni duhet ta përcaktojë qartë institucionin kryesor që do ta rregullojë mbulimin e mediave transmetuese gjatë fushatës së referendumit.

Vëzhguesit qytetarë dhe ndërkombëtarë

16. Në përputhje me angazhimet e OSBE-së dhe për të siguruar transparencë për të gjitha palët e interesuara, korniza ligjore duhet të parashohë vëzhgim partiak të të gjitha fazave të procesit të referendumit.
17. Për ta rritur llogaridhënien e vëzhguesve të zgjedhjeve dhe për ta inkurajuar transparencën, distinktivët e akreditimit duhet ta identifikojnë vëzhguesin, si dhe organizatën që e përfaqëson.

ANEKSI I: REZULTATET PËRFUNDIMTARE⁹¹

Zgjedhës të regjistruar	Pjesëmarrja		Vota të vlefshme 'Për'		Vota të vlefshme 'Kundër'	
	Numri	%	Numri	%	Numri	%
1.806.336	666.344	36,89%	609.427	91,46%	37.687	5,66%

⁹¹ Rezultatet e detajuara gjenden [në ueb-faqen e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve](#).

ANEKSI II: LISTA E VËZHguesve NË MISIONIN NDËRKOMBËTAR PËR VËZHGIMIN E REFERENDUMIT

Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës

Stefan	Schennach	Deputet	Austri	Shef i delegacionit
Bogdan	Torcătoriu	Sekretariati i APKE-së	Rumani	
Aleksander	Pociey	Deputet	Poloni	
Mart	Van De Ven	Deputet	Holandë	
Marco	Nicolini	Deputet	San Marino	
Anne	Godfrey	Sekretariati i APKE-së	Mbretëria e Bashkuar	
Richard	Barrett	Komisioni i Venedikut	Irlandë	
Gaël	Martin-Micallef	Komisioni i Venedikut	Francë	

Vëzhguesit afatshkurtër të MVR-së së ODIHR-it

Mira	Hoxha	Shqipëri
Uarda	Celami	Shqipëri
Michaela	Sivich	Austri
Manfred	Aschaber	Austri
Claudia Maria	Amry	Austri
Guido	Jacobs	Belgjikë
Wim	Dewaele	Belgjikë
Monika	Petrova	Bullgari
Ivaylo	Yordanov	Bullgari
Margarita	Nikolova-ivanova	Bullgari
Marek	Fiebich	Republika Çeke
Stepan	Cernousek	Republika Çeke
Eliška	Flídrová	Republika Çeke
Jana	Bedanova	Republika Çeke
Marketa	Tauerova	Republika Çeke
David	Hrdoušek	Republika Çeke
Marta	Hušková	Republika Çeke
Erik	Thau-knudsen	Danimarkë
Jytte	Vagner petersen	Danimarkë
Lars	Hollaender	Danimarkë
Torsten	Juul	Danimarkë
Karen	Skipper	Danimarkë
Birgit	Hjortlund	Danimarkë
Niels Erik	Nielsen	Danimarkë
Katre	Sai	Estoni
Timo	Koisti	Finlandë
Susanna	Vuorinen	Finlandë
Minna	Pesu	Finlandë
Nadia	Jurzac	Francë
Michel Auguste	Rivollier	Francë

Raporti përfundimtar i Misionit të ODIHR-it për Vëzhgimin e Referendumit

Ilhami	Gulcen	Francë
Etienne	Malingrey	Francë
Alexandre	Benz	Francë
Guillaume	Javourez	Francë
Helene	Devaux	Francë
Elizabeth	Tudor-Bezies	Francë
Laura	Similowski	Francë
Segolene	Tavel	Francë
Matthias	Vazquez	Francë
Robert	Werner	Gjermani
Rüdiger	Danapel	Gjermani
Anica	Heinlein	Gjermani
Ursula	Schulze-Aboubacar	Gjermani
Susanne	Neymeyer	Gjermani
Nele Teresa	Quecke	Gjermani
Mendel	Goldstein	Gjermani
Jutta	Krause	Gjermani
Gregor	Huebner	Gjermani
Reinhold	Osterhus	Gjermani
Simon	Gmeiner	Gjermani
Inken	Wiese	Gjermani
Norbert Hermann	Reiner	Gjermani
Horst	Denecke	Gjermani
Frank	Scholz	Gjermani
Nicolas	Nachtigall-Marten	Gjermani
Judith	Brand	Gjermani
Christian	Seiler	Gjermani
Reinhard	Hesse	Gjermani
Helmut	Klawonn	Gjermani
Volker	Wiemann	Gjermani
Peter	Besselmann	Gjermani
Gerda	Dopheide	Gjermani
Joerg	Lehnert	Gjermani
Karl	Pammer	Gjermani
Szabolcs	Varga	Hungari
Gyozo Jozsef	Gabriel	Hungari
Tamas andras	Vaszari	Hungari
Csilla	Göncöl	Hungari
Judit	Hidelmayer-Csicsman	Hungari
Hjördis	Stefánsdóttir	Islandë
Thengill	Björnsson	Islandë
Ciaran	Kinsella	Irlandë
Geraldine	O'Neill	Irlandë
Terence	Fleming	Irlandë
Robert	McDaid	Irlandë
Boaretto	Michele	Itali

Raporti përfundimtar i Misionit të ODIHR-it për Vëzhgimin e Referendumit

Zane	Zālīte	Letoni
Renata	Japertaite	Lituani
Kamile	Nemeiksyte	Lituani
Simone	Gerrits	Holandë
Onno Willem Cornelis	Hattinga van 'T Sant	Holandë
Janmaat	Freek	Holandë
Agnes	Wagenaar	Holandë
Maurits	Heek	Holandë
Even	Aronsen	Norvegji
Maria	Warsinska-Varsi	Norvegji
Hans	Dieset	Norvegji
Lewocki	Grzegorz	Poloni
Krzysztof Wilhelm	Lechowski	Poloni
Ionuț Florian	Coconea	Rumani
Juraj	Smolek	Sllovaki
Matej	Gregorec	Slloveni
Andreas	Persson	Suedi
Rebecca	Palmer	Suedi
Erik	Persson	Suedi
Robin	Söderberg	Suedi
Lars	Lagergren	Suedi
Andreas	Berglöf	Suedi
Ola	Segnestam Larsson	Suedi
Stina	Larserud	Suedi
Mansson	Michael	Suedi
Harder	Ronja	Zvicër
Luca	Laloli	Zvicër
Valérie	Nadrai	Zvicër
Evelin	Hutson-Hartmann	Zvicër
Thomas	Holzer	Zvicër
Martin	Damary	Zvicër
Daniele	D'esposito	Zvicër, Itali
Nataschia	Zullino	Zvicër, Itali
Cihat	Battaloglu	Turqi
Rostyslav	Palagusynets	Ukrainë
Peter	Hurrell	Mbretëri e Bashkuar
Stella	Hellier	Mbretëri e Bashkuar
Simon	Adams	Mbretëri e Bashkuar
Pascoe	Pascoe	Mbretëri e Bashkuar
Roger	Bryant	Mbretëri e Bashkuar
Andrew	Caldwell	Mbretëri e Bashkuar
Katherine	Robinson	Mbretëri e Bashkuar
Heregoo Ranga Murari	Kaushik	Mbretëri e Bashkuar
Howard	Knight	Mbretëri e Bashkuar
Emma	Stephens	Mbretëri e Bashkuar
Julius	Nkafu	Mbretëri e Bashkuar

Raporti përfundimtar i Misionit të ODIHR-it për Vëzhgimin e Referendumit

Stephen	Paul	Mbretëri e Bashkuar
Dally	Hakem	Mbretëri e Bashkuar
Julian	Nundy	Mbretëri e Bashkuar
Joseph	Worrall	Mbretëri e Bashkuar
Mary	Brooksbank	Mbretëri e Bashkuar
Catherine	Pidcock	Mbretëri e Bashkuar
Patricia	De'ath	Mbretëri e Bashkuar
Melanie	Leathers	Mbretëri e Bashkuar
Leslie	Paul	Mbretëri e Bashkuar
Jill	Dietrich	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Anslem	Gentle	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Rebecca	Ripley	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Shaun	Barcavage	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Giulio	Venezian	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Sima	Osdoby	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Tiffany	Glass	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Mary	Stegmaier	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
William	Lietzau	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Aubrey	Menarndt	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Jill	Mccracken	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Degee	Wilhelm	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Anthony	Barilla	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Rebecca	Graham	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
James	Berk	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Lee	Bauer	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Constance	Phlipot	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Jill	Venezian	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Garrett	Monti	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Syeda	Ali	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Dwight	Pelz	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Quentin	Lide	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Mark	Lasser	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Hoda	Zaki	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Jack	Dougherty	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Gerald	Mcdonough	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Edward	Gonzalez	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Naomi	Wachs	Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Vëzhguesit afatgjatë të MVR-së së ODIHR-it

Ivana	Kratka	Republika Çeke
Peter	Ravn	Danimarkë
Heidi	Teir-Setkic	Finlandë
Laurent	Campigotto	Francë
Sabrina	Rouigui	Francë

Raporti përfundimtar i Misionit të ODIHR-it për Vëzhgimin e Referendumit

Ingo	Buettner	Gjermani
Janina	Markewitsch	Gjermani
Jochen	Rinck	Gjermani
Elena	Gherciu	Moldavi
Cornelis	Kooijmans	Holandë
Turid	Polfus	Norvegji
Ruzica	Jovanovic	Serbi
Barbara	Egger Maldonado	Zvicër
Roman	Enzler	Zvicër
Alexandra	Von Arx	Zvicër
Mark	Waller	Mbretëri e Bashkuar
Paul	Wesson	Mbretëri e Bashkuar
Michael	Eldred	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Sheila	Jaghab	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Louis	Palmer III	Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Ekipi kryesor i MVR-së së ODIHR-it

Jan	Petersen	Norvegji	Shef i Misionit
Miso	Imamovic	Bosnjë dhe Hercegovinë	
Florence	Ganoux	Francë	
Angela	Ghilascu	Moldavi	
Maria	Krause	Rumani	
Daniela	Diaconu	Rumani	
Svetlana	Chetaikina	Federata Ruse	
Marek	Mracka	Sllovaki	
Robert	Bystricky	Sllovaki	
Ruslan	Ovezdurdyev	Turkmenistan	
Oleksandr	Stetsenko	Ukrainë	
John	Mellon	Mbretëri e Bashkuar	
Chris	Taylor	Mbretëri e Bashkuar	
Donald	Bisson	Shtetet e Bashkuara të Amerikës	

PËR OSBE/ODIHR-IN

Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) është institucioni kryesor i OSBE-së që u ndihmon vendeve anëtare "të sigurojnë respektim të plotë të të drejtave të njeriut dhe lirive fundamentale, t'i përmbahen sundimit të ligjit, t'i promovojnë parimet e demokracisë dhe (...) t'i ndërtojnë, t'i përforcojnë dhe t'i mbrojnë institucionet demokratike, si dhe ta promovojnë tolerancën në gjithë shoqërinë" (Dokumenti i Samitit të Helsinkit të vitit 1992). Kjo pjesë njihet si dimension i njerëzor i OSBE-së.

ODIHR-i, me seli në Varshavë të Polonisë, u krijua si Zyrë për Zgjedhje të Lira në Samitin e Parisit në vitin 1990 dhe filloi me punë në maj të vitit 1991. Një vit më vonë, emri i Zyrës u ndryshua për ta pasqyruar mandatin e zgjeruar, për t'i përfshirë të drejtat e njeriut dhe demokratizimin. Sot ajo ka mbi 150 të punësuar.

ODIHR-i është organizata kryesore në Evropë në fushën e **vëzhgimit të zgjedhjeve**. Për çdo vit, ajo e koordinon dhe e organizon shpërndarjen e mijëra vëzhguesve për të vlerësuar se a janë zhvilluar zgjedhjet në rajonin që e përfshin OSBE-ja në përputhje me angazhimet e OSBE-së, detyrimet dhe standardet e tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike dhe me legjislacionin kombëtar. Metodologjia e saj unike ofron një qasje të thellë në tërësinë e procesit zgjedhor. Me anë të projekteve për ndihmë, ODIHR-i u ndihmon vendeve anëtare ta përmirësojnë kornizën e tyre zgjedhore.

Aktivitetet e Zyrës në fushën e **demokratizimit** përfshijnë: sundimin e të drejtës, mbështetjen ligjore, qeverisjen demokratike, emigrimin dhe lirinë e lëvizjes, dhe barazinë gjinore. ODIHR-i për çdo vit zbaton një numër programesh të dedikuara për mbështetje, me të cilat synohet zhvillimi i strukturave demokratike.

ODIHR-i poashtu u ndihmon vendeve anëtare t'i përmbushin detyrimet e tyre për promovimin dhe mbrojtjen e **të drejtave të njeriut dhe lirive fundamentale** që është në përputhje me angazhimet e OSBE-së për dimensionet njerëzore. Kjo realizohet duke punuar me partnerë të ndryshëm për ta kultivuar bashkëpunimin, për t'i ndërtuar kapacitetet dhe për të ofruar ekspertizë në fushat tematike, duke i përfshirë të drejtat e njeriut në luftën kundër terrorizmit, avancimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut të personave të trafikuar, edukimin dhe trajnimin për të drejtat e njeriut, mbikëqyrjen dhe raportimin për të drejtat e njeriut, si dhe të drejtat e njeriut të grave dhe sigurinë e tyre.

Në fushën e **tolerancës** dhe të **mosdiskriminimit**, ODIHR-i u ofron përkrahje vendeve anëtare në përforcimin e kapacitetit për t'iu përgjigjur krimeve të urrejtjes dhe incidenteve të racizmit, ksenofobisë, antisemitizmit dhe formave të tjera të mostolerancës. Aktivitetet e ODIHR-it që kanë të bëjnë me tolerancën dhe mosdiskriminimin janë të fokusuar në këto fusha: legjislacioni, trajnimet për zbatimin e ligjit, mbikëqyrja, raportimi dhe ndjekja e përgjigjeve ndaj krimeve dhe incidenteve të motivuara nga urrejtja, si dhe aktivitete edukative për promovimin e tolerancës, respektit dhe mirëkuptimit të ndërsjellë.

ODIHR-i u ofron këshilla vendeve anëtare për politikatat e tyre që kanë të bëjnë me **romët dhe sintit**. Ajo e promovon ndërtimin e kapaciteteve dhe rrjetëzimin te komuniteti rom dhe ai sinti, dhe e inkurajon pjesëmarrjen e përfaqësuesve romë dhe të sinti në organet e politikë-bërjes.

Të gjitha aktivitetet e ODIHR-it realizohen në koordinim dhe në bashkëpunim të ngushtë me vendet anëtare të OSBE-së, institucionet dhe operacionet e OSBE-së në terren, si dhe me organizatat e tjera ndërkombëtare.

Më tepër informacione mund të gjeni në ueb-faqen e ODIHR-it (www.osce.org/odihr).